

10/2026



Instituti i Kosovës për Drejtësi
Kosovo Law Institute
Kosovski Institut Pravde

Qeverisja e Mirë, Sundimi i Ligjit dhe Integrimet Evropiane

Në programet e partive politike

Vlerësimi i programeve politike për
Zgjedhjet e Parakohshme
Parlamentare 2026

Autorë: Qemajl Marmullakaj, Naim Jakaj dhe Melos Kolshi

Ekipi redaktues: Ehat Miftaraj, Betim Musliu dhe Gzim Shala

Asnjë pjesë e këtij materiali nuk mund të printohet, kopjohet, shumëfishohet në çdo formë elektronike ose të shtypur, ose në çdo formë të shumëfishimit tjetër pa pajtimin e Institutit të Kosovës për Drejtësi.

Përmbajtja e këtij publikimi është përgjegjësi ekskluzive e Institutit të Kosovës për Drejtësi - IKD dhe ajo nuk pasqyron pikëpamjet e National Endowment for Democracy dhe Rockefeller Brothers Fund (RBF).

Implementuar nga:



Përkrahur nga:



RRETH IKD

IKD, Instituti i Kosovës për Drejtësi, është organizatë jo-qeveritare dhe jo-fitimprurëse e politikave publike, fabrikë e mendimeve e specializuar në sektorin e drejtësisë.

IKD

Rr. Ilaz Agushi
Prishtinë
info@kli-ks.org
www.kli-ks.org

Qershor 2026
Prishtinë, Republika e Kosovës

Lista e shkurtesave

LVV	Lëvizja Vetëvendosje!
PDK	Partia Demokratike e Kosovës
LDK	Lidhja Demokratike e Kosovës
AAK	Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës
KPM	Komisioni i Pavarur për Media
RTK	Radio Televizioni i Kosovës
KGJK	Këshilli Gjyqësor i Kosovës
KPK	Këshilli Prokurorial i Kosovës
KPMSHCK	Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil
APK	Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit
BE	Bashkimi Evropian
IKD	Instituti i Kosovës për Drejtësi

Tabela e përmbajtjes

Hyrje	7
Përmbledhje Ekzekutive.....	8
I. QEVERISJA E MIRË	9
Hyrje e përgjithshme	9
Programi politik i AAK-së.....	9
Programi politik i LVV-së	12
Programi politik i PDK-së.....	15
Programi politik i LDK-së.....	17
II. SUNDIMI I LIGJIT	20
Hyrje e përgjithshme	20
Programi politik i LVV-së	20
Programi politik i PDK-së.....	22
Programi politik i LDK-së.....	24
Programi politik i AAK-së.....	26
III. INTEGRIMI EVROPIAN.....	28
Hyrje e përgjithshme	28
Programi politik i PDK-së.....	29
Programi politik i LVV-së	31
Programi politik i LDK-së.....	32
Programi politik i AAK-së.....	34
Annex: Indikatorët për vlerësimin e programeve të partive politike	37

Hyrje

Kosova mbajti zgjedhjet e rregullta parlamentare më 9 shkurt 2025 dhe 28 dhjetor 2025 por për shkak të mungesës së dakordimit mes partive politike, procesi i konstituimit të Kuvendit dhe më pas i Qeverisë dështoi të prodhonte institucione funksionale. Tentativat e përsëritura për konstituimin e Kuvendit u shoqëruan me kontestime politike dhe juridike, duke rezultuar në një sërë vendimesh të Gjykatës Kushtetuese që përcaktuan parametrat kushtetues të këtij procesi. Pas një konstituimi të kontestuar nga Lista Serbe, Presidentja e vendit mandatoi dy kandidatë të partisë fituese për formimin e Qeverisë, por të dyja përpjekjet dështuan të sigurojnë shumicën parlamentare, çka solli shpërndarjen e Kuvendit dhe dekretimin e zgjedhjeve të jashtëzakonshme për 28 dhjetor 2025.

Ndryshe nga situata pas zgjedhjeve të shkurtit 2025, pas zgjedhjeve të dhjetorit 2025 ekzistonte qartësi kushtetuese lidhur me procedurën e konstituimit të Kuvendit. Ndërsa për sa i përket formimit të Qeverisë, rezultati zgjedhor i siguroi partisë fituese një shumicë të mjaftueshme për votimin e Qeverisë, e cila u formua pa vështirësi të mëdha. Megjithatë, vendi u përball me një ngërç të ri politik në procesin e zgjedhjes së Presidentit të Republikës. Me përfundimin e mandatit të Presidentes më 5 prill 2026, partitë politike nuk arritën të gjenin konsensus për zgjedhjen e kreut të ri të shtetit. Dështimi për të siguruar shumicën e kërkuar kushtetuese prodhoi një tjetër bllokadë institucionale, e cila çoi në shpërndarjen e Legjislaturës X dhe caktimin e zgjedhjeve të reja, të mbajtura më 7 qershor 2026, në përputhje me obligimet kushtetuese.

Në këtë kontekst institucional të tej zgjatur dhe në mungesë të qeverisjes funksionale, programet politike të partive marrin një rëndësi të posaçme, pasi ato paraqesin orientimet e tyre qeverisëse, angazhimet publike dhe pritshmëritë që i ofrohen elektoratit. Duke u mbështetur në mandatin e saj ligjor dhe profesional për monitorimin e qeverisjes së mirë, sundimit të ligjit, dhe integrimin evropian, Instituti i Kosovës për Drejtësi (IKD), përmes Programit për Qeverisje të Mirë, do të realizojë një vlerësim gjithëpërfshirës të programeve politike të partive pjesëmarrëse në zgjedhjet e 7 qershorit 2026. Vlerësimi do të fokusohet në tre shtylla themelore-qeverisjen e mirë dhe sundimin e rendit dhe ligjit, dhe integrimin evropian duke siguruar një qasje të unifikuar, të standardizuar dhe të matshme përmes një seti indikatorësh të zhvilluar posaçërisht për këtë qëllim. Këta indikatorë do të shërbejnë si bazë objektive për matjen e cilësisë, koherencës dhe realizueshmërisë së angazhimeve programore të partive politike në raport me standardet e qeverisjes demokratike, sundimit të ligjit dhe integrimin evropian.

Përmbledhje Ekzekutive

Instituti i Kosovës për Drejtësi (IKD), në kuadër të mandatit të tij për monitorimin e qeverisjes së mirë, sundimit të ligjit dhe integritimit evropian, realizon në mënyrë të vazhdueshme vlerësimin e programeve politike të partive parlamentare në Kosovë. Në funksion të zgjedhjeve parlamentare të 7 qershorit 2026, IKD ka analizuar programet politike të Lëvizjes Vetëvendosje (LVV), Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK) dhe Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), duke vlerësuar shkallën në të cilën ato adresojnë standardet e qeverisjes demokratike, sundimit të ligjit dhe integritimit evropian.

Vlerësimi është bazuar në një metodologji të standardizuar me indikatorë të matshëm, të zhvilluar nga IKD, vlerësim i cili analizon përmbajtjen, koherencën, konkretizimin dhe realizueshmërinë e zotimeve programore në fusha specifike. Analiza tregon se, ndonëse të gjitha partitë trajtojnë temat kryesore që ndërlidhen me zhvillimin institucional të vendit, shumica e zotimeve mbeten në nivel të orientimeve strategjike dhe deklarimeve politike, pa u shoqëruar me objektiva të matshme, afate kohore dhe mekanizma të qartë monitorimi.

Në fushën e qeverisjes së mirë, programi i AAK-së rezulton më gjithëpërfshirësi, veçanërisht në aspektin e transparencës institucionale, konsultimit publik, digjitalizimit dhe rolit të institucioneve të pavarura mbikëqyrëse. LDK paraqet vizionin më të avancuar për transformimin digjital dhe qeverisjen elektronike, ndërsa LVV dhe PDK fokusohen më shumë në reforma sektoriale dhe modernizim institucional, duke adresuar në mënyrë më të kufizuar transparencën, depolitizimin e administratës dhe llogaridhënien.

Në fushën e sundimit të ligjit, programi i LVV-së paraqet nivelin më të lartë të elaborimit, veçanërisht për sa i përket reformës në drejtësi, luftimit të korrupsionit dhe vetingut. Megjithatë, asnjëra nga partitë nuk i referohet në mënyrë substanciale Strategjisë për Sundimin e Ligjit 2021–2026, Deklaratës së Përbashkët të Zotimeve apo rekomandimeve të Komisionit të Venecias. Po ashtu, tema të rëndësishme si integriteti i prokurimit publik, pavarësia e mediave dhe forcimi i mekanizmave institucionalë kundër korrupsionit mbeten të adresuara vetëm pjesërisht ose fare.

Në fushën e integritimit evropian, të gjitha partitë e konsiderojnë anëtarësimin në Bashkimin Evropian objektiv strategjik. PDK rezulton me vlerësimin më të lartë, duke paraqitur objektiva konkrete si fitimi i statusit kandidat për anëtarësim në BE ndërsa LVV trajton në mënyrë më të drejtpërdrejtë Planin e Rritjes. Nga ana tjetër LDK dhe AAK ruajnë një orientim të qartë evropian, por me më pak masa konkrete për realizimin e objektivave integruese.

Në përgjithësi, analiza konstaton se programet politike ofrojnë vizione dhe prioritete të ndryshme për zhvillimin e vendit, por vazhdojnë të karakterizohen nga mungesa e objektivave të matshme, treguesve të performancës dhe mekanizmave të qartë të monitorimit dhe raportimit. Për rrjedhojë, mbetet sfidues vlerësimi i realizueshmërisë së zotimeve programore dhe matja e nivelit të llogaridhënies së partive politike ndaj qytetarëve. Ky vlerësim synon të kontribuojë në rritjen e transparencës politike dhe të ofrojë një bazë objektive për debat publik mbi cilësinë e programeve qeverisëse në Kosovë.

I. QEVERISJA E MIRË

Hyrje e përgjithshme

Analiza e programeve politike të Lëvizjes Vetëvendosje, Partisë Demokratike të Kosovës, Lidhjes Demokratike të Kosovës dhe Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës tregon se qeverisja e mirë vazhdon të paraqitet si një nga parakushtet kryesore për forcimin e institucioneve demokratike, përmirësimin e ofrimit të shërbimeve publike dhe rritjen e besimit të qytetarëve në institucionet shtetërore. Në vitet e fundit, çështje si transparenca institucionale, llogaridhënia publike, depolitizimi i administratës, barazia gjinore dhe transformimi digjital i institucioneve kanë qenë pjesë e vazhdueshme e debatit publik dhe e rekomandimeve të organizatave vendore dhe ndërkombëtare.

Analiza tregon dallime të konsiderueshme ndërmjet programeve politike sa i përket trajtimit të këtyre çështjeve. Disa programe fokusohen më shumë në modernizimin teknologjik dhe digjitalizimin e administratës publike, ndërsa të tjera adresojnë në një masë më të madhe transparencën institucionale apo forcimin e institucioneve të pavarura. Megjithatë, në shumicën e rasteve mungojnë objektiva të matshme, afate kohore, tregues të performancës dhe mekanizma monitorimi që do të mundësonin vlerësimin e zbatimit të reformave të propozuara.

Në këtë kontekst, programet politike janë vlerësuar në bazë të pesë indikatorëve: (1) barazia gjinore dhe të drejtat e grave, (2) transparenca dhe llogaridhënia në punën e Qeverisë dhe Kuvendit, (3) depolitizimi i administratës publike, (4) digjitalizimi dhe qeverisja elektronike, si dhe (5) llogaridhënia institucionale. Vlerësimi synon të identifikojë shkallën në të cilën partitë politike ofrojnë politika, reforma dhe masa konkrete për forcimin e standardeve të qeverisjes së mirë dhe modernizimin e administratës publike në Kosovë.

Renditja	Partia Politike	Barazia Gjinore	Transparenca & Llogaridhënia	Depolitizimi i Administratës	Digjitalizimi & E-Qeverisja	Llogaridhënia Institucionale	Totali
1	AAK	2	3	2	4	2	13
2	LVV	3	0	0	3	1	7
3	PDK	1	0	1	4	1	7
4	LDK	0	0	0	5	1	6

Tabela 1. Vlerësimi i programeve politike në fushën e qeverisjes së mirë

Programi politik i AAK-së

Vlerësim i përgjithshëm në fushën e Qeverisjes së Mirë

Programi politik i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës paraqet qasjen më të zhvilluar në fushën e qeverisjes së mirë krahasuar me subjektet e tjera politike të analizuar. Programi adreson një numër të konsiderueshëm çështjesh që ndërlidhen me transparencën institucionale, depolitizimin e administratës publike, digjitalizimin e shërbimeve publike dhe forcimin e institucioneve të pavarura mbikëqyrëse. Në veçanti, programi përmban masa konkrete për transparencën e qeverisjes, konsultimin publik dhe modernizimin e administratës përmes

transformimit digjital, duke ofruar një qasje më të strukturuar sesa programet e partive të tjera politike.

Megjithatë, edhe pse programi trajton më shumë indikatorë të qeverisjes së mirë sesa subjektet e tjera, shumica e zotimeve mbeten në nivel të orientimeve programore dhe nuk shoqërohen me objektiva të matshme, afate kohore apo mekanizma të qartë monitorimi dhe raportimi. Po ashtu, programi nuk ofron zgjidhje të detajuara për disa prej sfidave më të rëndësishme të administratës publike, si kufizimi i emërimeve me ushtrues detyre, forcimi i sistemit meritokratik të rekrutimit dhe zhvillimi i mekanizmave të avancuar të kontrollit dhe llogaridhënies institucionale.

Indikatori: Barazia gjinore dhe të drejtat e grave në programin qeverisës

Vlerësimi: 2 pikë nga 5 pikë të mundshme

Programi i AAK-së e trajton barazinë gjinore kryesisht nga perspektiva e fuqizimit ekonomik të grave dhe rritjes së pjesëmarrjes së tyre në tregun e punës. Programi përmban masa konkrete për trajnimin dhe rikualifikimin profesional të grave, lehtësime për bizneset që punësojnë gra dhe objektivin për uljen e papunësisë së grave gjatë mandatit qeverisës. Po ashtu, programi parasheh mbështetje për gratë në kulturë, art dhe industri kreative.

Megjithëse këto masa kontribuojnë në fuqizimin ekonomik të grave, programi nuk trajton dimensionet e tjera të barazisë gjinore. Mungojnë masa për zbatimin e Ligjit për Barazi Gjinore, rritjen e përfaqësimit të grave në pozita vendimmarrëse, luftimin e dhunës me bazë gjinore dhe mekanizmat institucionalë për monitorimin e zbatimit të politikave gjinore.

Për rrjedhojë, programi adreson disa elemente të indikatorit përmes masave konkrete ekonomike, por nuk ofron një qasje gjithëpërfshirëse ndaj barazisë gjinore.

Indikatori: Transparenca dhe llogaridhënia në punën e Qeverisë dhe Kuvendit

Vlerësimi: 3 pikë nga 5 pikë të mundshme

Programi i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës është programi që adreson më drejtpërdrejt transparencën dhe llogaridhënien institucionale. Programi parasheh krijimin e një Platforme Kombëtare për Transparencë në Qeverisje, përmes së cilës qytetarët dhe bizneset do të mund të monitorojnë në kohë reale shpenzimet publike, kontratat e prokurimit dhe projektet qeveritare. Po ashtu, programi parasheh konsultimin e rregullt me shoqërinë civile, bizneset dhe komunat, si dhe vendosjen e konsultimeve të detyrueshme paraprake me shoqërinë civile, mediat, partnerët socialë dhe odat ekonomike para miratimit të ligjeve me interes publik ose ekonomik.

Këto masa adresojnë drejtpërdrejt disa nga elementet kryesore të metodologjisë, veçanërisht konsultimin publik dhe transparencën në procesin e vendimmarrjes. Megjithatë, programi nuk paraqet mekanizma të detajuar për monitorimin e zbatimit të këtyre politikave, nuk përcakton afate konkrete dhe nuk ofron tregues të matshëm për vlerësimin e rezultateve. Për rrjedhojë,

programi vlerësohet me 3 pikë, pasi përmban masa konkrete, por jo një plan plotësisht të operacionalizuar dhe të matshëm.

Indikatori: Depolitizimi i administratës publike

Vlerësimi: 2 pikë nga 5 pikë të mundshme

Programi i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës është i vetmi program që e trajton në mënyrë të drejtpërdrejtë nevojën për një administratë publike profesionale dhe të pavarur nga ndikimet politike. Programi parasheh zhvillimin e trajnimeve të vazhdueshme profesionale për nëpunësit publikë dhe garantimin e sigurisë juridike për administratën publike. Po ashtu, programi përmban referenca ndaj meritokracisë dhe avancimit profesional të bazuar në performancë dhe profesionalizëm në sektorë të caktuar, si arsimit dhe shëndetësia.

Megjithatë, programi nuk paraqet masa konkrete për reformimin e sistemit të rekrutimit në administratën publike, nuk adreson çështjen e emërimeve me ushtrues detyre dhe nuk trajton rolin e institucioneve përgjegjëse për mbikëqyrjen e shërbimit civil, përfshirë Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës. Po ashtu, mungojnë mekanizmat e monitorimit dhe garantitë institucionale që do të siguronin zbatimin e parimit të depolitizimit.

Për rrjedhojë, programi adreson disa elemente të këtij indikatori, por nuk ofron një plan të plotë dhe të operacionalizuar për depolitizimin e administratës publike.

Indikatori: Digjitalizimi dhe qeverisja elektronike

Vlerësimi: 4 pikë nga 5 pikë të mundshme

Programi i AAK-së paraqet një qasje të avancuar ndaj qeverisjes elektronike dhe modernizimit të administratës publike. Programi parasheh zhvillimin e platformave moderne për ofrimin e shërbimeve publike, sisteme të integruara për komunikim institucional, arkivim digjital dhe zhvillimin e identitetit digjital shtetëror.

Po ashtu, programi parasheh monitorimin në kohë reale të shpenzimeve publike dhe kontratave të prokurimit përmes platformave digjitale, si dhe integrimin e institucioneve shëndetësore përmes Sistemit Informativ Shëndetësor dhe Kartelës Elektronike të Pacientit. Programi adreson në mënyrë të drejtpërdrejtë lehtësimin e qasjes së qytetarëve në shërbime publike dhe përdorimin e teknologjisë për rritjen e efikasitetit institucional.

Megjithatë, programi nuk e elaboron në mënyrë të plotë ndërveprueshmërinë e përgjithshme të sistemeve shtetërore dhe nuk paraqet një model të unifikuar të qeverisjes elektronike në nivelin që paraqitet në programin e LDK-së. Për këtë arsye, programi vlerësohet me 4 pikë.

Indikatori 5: Llogaridhënia institucionale

Vlerësimi: 2 pikë nga 5 pikë të mundshme

Programi i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës adreson më së shumti elementet e llogaridhënies institucionale krahasuar me subjektet e tjera politike. Programi parasheh forcimin e pavarësisë financiare dhe operacionale të institucioneve të pavarura mbikëqyrëse, përfshirë Auditorin e Përgjithshëm, Avokatin e Popullit dhe Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit. Këto institucione përbëjnë mekanizmat kryesorë të kontrollit dhe mbikëqyrjes së institucioneve publike dhe luajnë rol të rëndësishëm në forcimin e llogaridhënies institucionale.

Po ashtu, programi e trajton luftën kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar si përgjegjësi institucionale dhe jo vetëm si objekt politik. Megjithatë, programi nuk paraqet masa konkrete për raportim publik periodik, auditim të brendshëm dhe të jashtëm, plane integriteti institucional apo mekanizma të monitorimit të performancës së institucioneve publike. Për më tepër, mungojnë objektiva të matshme dhe afate kohore për realizimin e këtyre synimeve.

Për rrjedhojë, programi adreson disa prej elementeve kryesore të llogaridhënies institucionale, por nuk ofron një sistem të plotë të mbikëqyrjes dhe kontrollit institucional.

Përfundim

Në tërësi, programi i AAK-së paraqet qasjen më gjithëpërfshirëse në fushën e qeverisjes së mirë ndër programet e analizuara. Forca kryesore e programit qëndron në trajtimin e transparencës institucionale, digjitalizimit të administratës publike dhe forcimit të institucioneve të pavarura mbikëqyrëse. Megjithatë, programi mbetet i kufizuar në operacionalizimin e shumë prej reformave të propozuara, pasi mungojnë objektiva të matshme, tregues të performancës dhe mekanizma të qartë monitorimi. Për rrjedhojë, programi demonstroi orientim të qartë drejt modernizimit të qeverisjes dhe forcimit të institucioneve publike, por nuk ofron një plan plotësisht të detajuar dhe të matshëm për adresimin sistematik të të gjitha sfidave që ndërliidhen me qeverisjen e mirë.

Programi politik i LVV-së

Vlerësim i përgjithshëm në fushën e Qeverisjes së Mirë

Programi politik i Lëvizjes Vetëvendosje e trajton qeverisjen e mirë kryesisht përmes reformave sektoriale, fuqizimit të sundimit të ligjit, luftimit të korrupsionit dhe digjitalizimit të disa shërbimeve publike. Programi përmban masa konkrete në fusha të caktuara, veçanërisht në raport me fuqizimin ekonomik të grave, luftimin e korrupsionit dhe modernizimin e disa proceseve administrative përmes teknologjisë. Megjithatë, programi adreson në mënyrë të kufizuar disa prej elementeve themelore të qeverisjes së mirë, si transparenca institucionale, depolitizimi i administratës publike dhe mekanizmat e llogaridhënies.

Një nga karakteristikat kryesore të programit është fokusimi në reforma dhe iniciativa sektoriale pa i ndërliidhur ato me një qasje më të gjerë institucionale të qeverisjes së mirë. Po ashtu, programi nuk paraqet reflektim mbi mangësitë dhe sfidat e evidentuara gjatë mandatit të kaluar qeverisës dhe nuk ofron qartësi të mjaftueshme lidhur me ndryshimet që synohen në qasjen e ardhshme qeverisëse për adresimin e këtyre sfidave. Për më tepër, shumica e zotimeve

nuk shoqërohen me objektiva të matshme, afate kohore apo mekanizma monitorimi që do të mundësonin vlerësimin e progresit në zbatimin e reformave të propozuara.

Indikatori: Barazia gjinore dhe të drejtat e grave në programin qeverisës

Vlerësimi: 3 pikë nga 5 pikë të mundshme

Programi i Lëvizjes Vetëvendosje e trajton barazinë gjinore kryesisht përmes fuqizimit ekonomik të grave dhe rritjes së pjesëmarrjes së tyre në tregun e punës. Programi përmban masa konkrete si Programi “Superpuna për Gratë”, i cili synon mbështetjen e grave që hyjnë ose rikthehen në tregun e punës, si dhe masa të tjera mbështetëse për lehonat dhe pjesëmarrjen ekonomike të grave. Po ashtu, programi përcakton objektiva konkrete për rritjen e përfaqësimit të grave në Forcën e Sigurisë së Kosovës.

Megjithatë, programi nuk e trajton barazinë gjinore si politikë gjithëpërfshirëse të qeverisjes. Nuk adresohet zbatimi i Ligjit për Barazi Gjinore, mungojnë masa për rritjen e pjesëmarrjes së grave në pozita vendimmarrëse në administratë dhe ndërmarrje publike, si dhe nuk paraqiten politika të strukturuar për parandalimin dhe luftimin e dhunës me bazë gjinore. Po ashtu, mungojnë mekanizmat monitorues dhe instrumentet e llogaridhënies për zbatimin e politikave gjinore.

Për rrjedhojë, programi i LVV-së është programi që adreson më së shumti këtë indikator, por nuk përmbush në tërësi elementet e përcaktuara në metodologjinë e vlerësimit.

Indikatori: Transparenca dhe llogaridhënia në punën e Qeverisë dhe Kuvendit

Vlerësimi: 0 pikë nga 5 pikë të mundshme

Programi i Lëvizjes Vetëvendosje nuk përmban masa konkrete që adresojnë transparencën dhe llogaridhënien në punën e Qeverisë dhe Kuvendit sipas elementeve të përcaktuara në metodologjinë e vlerësimit. Edhe pse në program identifikohen referenca sporadike për transparencën në sektorë të caktuar, si energjia dhe funksionimi i tregjeve, ato nuk ndërlidhen me procesin e hartimit të politikave publike, konsultimet publike, publikimin e raporteve institucionale apo transparencën buxhetore.

Mungesa e trajtimit të kësaj fushe është veçanërisht e rëndësishme duke pasur parasysh debatet e zhvilluara gjatë mandatit të kaluar lidhur me transparencën e vendimmarrjes qeveritare dhe qasjen e publikut në dokumentet strategjike të qeverisë. Megjithatë, programi nuk paraqet masa konkrete që do të adresonin këto çështje në të ardhmen. Për rrjedhojë, programi vlerësohet me 0 pikë.

Indikatori 3: Depolitizimi i administratës publike

Vlerësimi: 0 pikë nga 5 pikë të mundshme

Programi i Lëvizjes Vetëvendosje nuk përmban masa apo politika që adresojnë drejtpërdrejt depolitizimin e administratës publike sipas kritereve të përcaktuara në metodologjinë e vlerësimit. Në program nuk identifikohen zotime që lidhen me rekrutimin meritokratik, kufizimin e ndikimit politik në administratë apo forcimin e rolit të institucioneve të pavarura mbikëqyrëse të shërbimit civil.

Po ashtu, programi nuk trajton çështjen e ushtruesve të detyrës, e cila ka qenë një nga temat më të diskutuara gjatë mandatit të kaluar qeverisës. Mungojnë masa që do të adresonin emërimet afatgjata me ushtrues detyre dhe forcimin e sigurisë juridike për nëpunësit civilë.

Për rrjedhojë, programi nuk adreson elementet e këtij indikatori dhe vlerësohet me 0 pikë.

Indikatori: Digjitalizimi dhe qeverisja elektronike

Vlerësimi: 2 pikë nga 5 pikë të mundshme

Programi i LVV-së përmban një numër iniciativash që lidhen me digjitalizimin e sektorëve të ndryshëm publikë. Programi parasheh digjitalizimin e shërbimeve konsullore, sistemit të drejtësisë, procesit të aplikimit për subvencione bujqësore, raportimit të shkeljeve të të drejtave në punë dhe administrimit të sistemit arsimor.

Po ashtu, programi parasheh zhvillimin e një valute digjitale të Kosovës të bazuar në teknologjinë blockchain dhe zgjerimin e përdorimit të teknologjisë në arsim. Këto masa kontribuojnë në rritjen e efikasitetit institucional dhe lehtësimin e qasjes së qytetarëve në disa shërbime publike.

Megjithatë, shumica e masave janë të natyrës sektoriale dhe nuk paraqesin një strategji të përgjithshme të qeverisjes elektronike. Programi nuk trajton në mënyrë të qartë ndërveprueshmërinë e sistemeve shtetërore, integrimin e platformave publike apo zhvillimin e një infrastrukture të unifikuar të e-qeverisjes. Po ashtu, mungojnë masa që lidhen me inteligjencën artificiale në administratën publike dhe sistemet e integruara shtetërore. Për rrjedhojë, programi vlerësohet me 2 pikë.

Indikatori 5: Llogaridhënia institucionale

Vlerësimi: 1 pikë nga 5 pikë të mundshme

Programi i Lëvizjes Vetëvendosje e trajton llogaridhënien institucionale kryesisht përmes luftimit të korrupsionit dhe pasurimit të pajustificueshëm. Programi parasheh themelimin e Byrosë për Konfiskimin e Pasurisë së Pajustificueshme, krijimin e një prokurorie të specializuar për luftimin e korrupsionit dhe krimin të organizuar, si dhe reforma në sistemin e prokurimit publik.

Këto masa synojnë rritjen e përgjegjësisë institucionale dhe luftimin e keqpërdorimeve në sektorin publik. Megjithatë, programi e trajton llogaridhënien kryesisht nga perspektiva e ndjekjes penale dhe luftimit të korrupsionit. Nuk paraqiten masa konkrete për auditim të pavarur, raportim publik institucional, kontroll të brendshëm apo plane të integritetit institucional. Po ashtu, mungojnë mekanizma të qartë monitorimi dhe vlerësimi të performancës së institucioneve publike.

Për rrjedhojë, programi adreson vetëm pjesërisht elementet e këtij indikatori dhe vlerësohet me 1 pikë.

Përfundim

Në tërësi, programi i LVV-së paraqet një qasje selektive ndaj qeverisjes së mirë, duke vendosur theks në luftimin e korrupsionit, disa aspekte të barazisë gjinore dhe digjitalizimin e shërbimeve publike. Megjithatë, programi nuk adreson në mënyrë substanciale transparencën institucionale, depolitizimin e administratës publike dhe ndërtimin e mekanizmave të qëndrueshëm të llogaridhënies. Për më tepër, mungon një analizë kritike e sfidave të hasura gjatë qeverisjes së deritanishme dhe një shpjegim i qartë se çfarë do të ndryshojë në qasjen e ardhshme qeverisëse. Për rrjedhojë, programi demonstroi orientim drejt reformave në disa fusha të veçanta, por nuk ofron një vizion plotësisht të integruar dhe të operacionalizuar për avancimin e qeverisjes së mirë në Kosovë.

Programi politik i PDK-së

Vlerësim i përgjithshëm në fushën e Qeverisjes së Mirë

Programi politik i Partisë Demokratike të Kosovës adreson qeverisjen e mirë kryesisht përmes modernizimit të institucioneve publike, transformimit digjital, forcimit të kapaciteteve shtetërore dhe luftimit të korrupsionit. Krahasuar me partitë e tjera politike, programi paraqet një fokus më të theksuar në digjitalizimin e shërbimeve publike, zhvillimin e infrastrukturës digjitale dhe përdorimin e teknologjisë si mjet për rritjen e efikasitetit institucional dhe reduktimin e burokracisë. Po ashtu, programi përmban referenca ndaj profesionalizmit dhe meritokracisë në disa sektorë të administratës publike dhe e ndërlikoi reformën administrative me procesin e integritetit evropian.

Megjithatë, programi trajton në mënyrë të kufizuar disa prej komponentëve kryesorë të qeverisjes së mirë. Transparenca dhe llogaridhënia në punën e Qeverisë dhe Kuvendit mbeten pothuajse të paadresuara, ndërsa depolitizimi i administratës publike trajtohet vetëm në mënyrë të tërthortë përmes referencave të përgjithshme ndaj profesionalizmit. Po ashtu, masat që lidhen me barazinë gjinore dhe llogaridhënien institucionale mbeten të kufizuara dhe kryesisht deklarative. Në shumicën e rasteve mungojnë objektiva të matshme, afate kohore dhe mekanizma monitorimi që do të mundësonin vlerësimin e progresit në realizimin e reformave të propozuara.

Indikatori: Barazia gjinore dhe të drejtat e grave në programin qeverisës

Vlerësimi: 1 pikë nga 5 pikë të mundshme

Programi i PDK-së përmban disa masa që lidhen me mbështetjen e grave në tregun e punës, përfshirë mbështetjen për lehonat, mbrojtjen e vendit të punës gjatë lehonisë dhe masa për avancimin profesional të grave në Policinë e Kosovës.

Megjithatë, këto masa paraqiten në mënyrë të kufizuar dhe nuk shoqërohen me një qasje të gjerë ndaj barazisë gjinore. Programi nuk identifikon pabarazinë gjinore si problem strukturor, nuk adreson pjesëmarrjen e grave në vendimmarrje, nuk përmban masa për zbatimin e Ligjit për Barazi Gjinore dhe nuk trajton në mënyrë specifike çështjen e dhunës me bazë gjinore. Për rrjedhojë, trajtimi i këtij indikator mbetet i kufizuar dhe kryesisht deklarativ.

Indikatori: Transparenca dhe llogaridhënia në punën e Qeverisë dhe Kuvendit

Vlerësimi: 0 pikë nga 5 pikë të mundshme

Programi i Partisë Demokratike të Kosovës nuk përmban masa që lidhen drejtpërdrejt me transparencën dhe llogaridhënien në punën e Qeverisë dhe Kuvendit sipas kriterëve të këtij indikator. Nuk identifikohen zotime që parashohin konsultime publike të detyrueshme, publikimin sistematik të raporteve institucionale, transparencën buxhetore apo transparencën në procesin e kontraktimit publik.

Megjithëse programi trajton reforma në fusha të ndryshme të qeverisjes dhe administratës publike, ai nuk adreson në mënyrë specifike mekanizmat për rritjen e transparencës së institucioneve dhe forcimin e kontrollit publik mbi vendimmarrjen. Për rrjedhojë, programi vlerësohet me 0 pikë.

Indikatori: Depolitizimi i administratës publike

Vlerësimi: 1 pikë nga 5 pikë të mundshme

Programi i Partisë Demokratike të Kosovës nuk e trajton drejtpërdrejt depolitizimin e administratës publike si prioritet të veçantë reformues. Megjithatë, në program identifikohen referenca ndaj profesionalizmit dhe meritokracisë, veçanërisht në kapitullin që trajton shërbimin diplomatik, ku theksohet nevoja për përzgjedhje meritorë dhe forcim të kapaciteteve profesionale.

Po ashtu, programi e ndërlihd reformën administrative me procesin e integritit evropian dhe përmirësimin e kapaciteteve institucionale. Megjithatë, këto zotime mbeten në nivel të orientimeve të përgjithshme dhe nuk shoqërohen me masa konkrete për kufizimin e ndikimit politik në administratë. Programi nuk trajton rekrutimin meritokratik në shërbimin civil, nuk adreson çështjen e ushtruesve të detyrës dhe nuk paraqet mekanizma institucionale për forcimin e pavarësisë profesionale të administratës publike.

Për rrjedhojë, programi demonstroi një orientim të përgjithshëm drejt profesionalizimit, por nuk adreson në mënyrë substanciale depolitizimin e administratës publike.

Indikatori: Digjitalizimi dhe qeverisja elektronike

Vlerësimi: 3 pikë nga 5 pikë të mundshme

Programi i PDK-së i kushton rëndësi të konsiderueshme transformimit digjital të institucioneve publike. Programi parashih digjitalizimin e shëndetësisë përmes dosjeve elektronike mjekësore, rezervimeve online dhe sistemeve të referimit digjital, si dhe digjitalizimin e proceseve në sistemin e drejtësisë.

Një kapitull i veçantë i kushtohet sovranitetit digjital, inteligjencës artificiale dhe zhvillimit të qendrave kombëtare të të dhënave. Programi gjithashtu synon digjitalizimin e plotë të shërbimeve publike dhe reduktimin e burokracisë administrative.

Megjithatë, shumica e masave paraqiten në mënyrë sektoriale dhe programi nuk ofron një model të integruar të qeverisjes elektronike apo një vizion të qartë për ndërveprueshmërinë e sistemeve shtetërore. Po ashtu, mungojnë objektiva të matshme dhe mekanizma monitorimi për zbatimin e reformave të propozuara. Për rrjedhojë, programi vlerësohet me 3 pikë.

Indikatori 5: Llogaridhënia institucionale

Vlerësimi: 1 pikë nga 5 pikë të mundshme

Programi i Partisë Demokratike të Kosovës e trajton llogaridhënien institucionale në mënyrë të kufizuar dhe kryesisht përmes referencave ndaj luftimit të korrupsionit dhe krimit të organizuar. Programi parasheh forcimin e kapaciteteve institucionale për luftimin e korrupsionit dhe promovon eliminimin e nepotizmit dhe keqpërdorimeve, veçanërisht në iniciativat që lidhen me zhvillimin ekonomik dhe investimet publike.

Megjithatë, këto zotime mbeten kryesisht në nivel deklarativ dhe nuk shoqërohen me masa konkrete për raportim publik, auditim të pavarur, kontroll të brendshëm apo forcimin e mekanizmave institucionale të mbikëqyrjes. Programi nuk adreson institucionet e pavarura mbikëqyrëse dhe nuk paraqet plane integriteti apo tregues të performancës për institucionet publike.

Për rrjedhojë, trajtimi i llogaridhënies institucionale mbetet i kufizuar dhe programi vlerësohet me 1 pikë.

Përfundim

Në tërësi, programi i PDK-së paraqet një qasje të orientuar drejt modernizimit institucional dhe transformimit digjital të administratës publike, duke e konsideruar teknologjinë dhe zhvillimin e kapaciteteve institucionale si instrumente kryesore për përmirësimin e qeverisjes. Megjithatë, programi mbetet më pak i zhvilluar në aspektin e transparencës institucionale, depolitizimit të administratës publike dhe ndërtimit të mekanizmave të qëndrueshëm të llogaridhënies. Për më tepër, një pjesë e konsiderueshme e zotimeve mbeten në nivel strategjik dhe nuk shoqërohen me masa konkrete të zbatimit, tregues të performancës apo mekanizma monitorimi. Për rrjedhojë, programi demonstroi potencial për avancimin e modernizimit institucional, por nuk ofron një qasje plotësisht të operacionalizuar dhe gjithëpërfshirëse për forcimin e qeverisjes së mirë në Kosovë.

Programi politik i LDK-së

Vlerësim i përgjithshëm në fushën e Qeverisjes së Mirë

Programi politik i Lidhjes Demokratike të Kosovës e trajton qeverisjen e mirë kryesisht përmes modernizimit të administratës publike, transformimit digjital të institucioneve dhe përmirësimit të efikasitetit të ofrimit të shërbimeve publike. Krahasuar me subjektet e tjera politike, programi paraqet qasjen më të avancuar në fushën e digjitalizimit dhe qeverisjes elektronike, duke propozuar një sërë reformash që lidhen me interoperabilitetin e sistemeve shtetërore, zhvillimin e infrastrukturës digjitale dhe transformimin e platformës e-Kosova në një pikë të vetme të ofrimit të shërbimeve publike. Programi gjithashtu adreson disa elemente që ndërlidhen me luftimin e korrupsionit dhe rritjen e efikasitetit institucional.

Megjithatë, programi trajton në mënyrë shumë të kufizuar disa prej shtyllave themelore të qeverisjes së mirë. Barazia gjinore dhe të drejtat e grave nuk adresohen fare, ndërsa transparenca dhe llogaridhënia në punën e Qeverisë dhe Kuvendit, si dhe depolitizimi i administratës publike, mbeten jashtë fokusit programor. Po ashtu, programi nuk paraqet masa konkrete për auditim të pavarur, raportim publik, kontroll të brendshëm dhe mekanizma të integritetit institucional. Në shumicën e rasteve mungojnë objektiva të matshme, tregues të

performancës dhe mekanizma monitorimi që do të mundësonin vlerësimin e progresit në zbatimin e reformave të propozuara.

Indikatori: Barazia gjinore dhe të drejtat e grave në programin qeverisës

Vlerësimi: 0 pikë nga 5 pikë të mundshme

Programi i LDK-së nuk përmban masa, politika apo objektiva që adresojnë drejtpërdrejt barazinë gjinore dhe të drejtat e grave. Në program nuk identifikohen zotime që lidhen me fuqizimin ekonomik të grave, përfaqësimin e tyre në vendimmarrje, zbatimin e Ligjit për Barazi Gjinore apo luftimin e dhunës me bazë gjinore.

Për rrjedhojë, programi nuk adreson elementet e përcaktuara në metodologjinë e vlerësimit dhe vlerësohet me 0 pikë

Indikatori: Transparenca dhe llogaridhënia në punën e Qeverisë dhe Kuvendit

Vlerësimi: 0 pikë nga 5 pikë të mundshme

Programi i Lidhjes Demokratike të Kosovës nuk përmban masa apo politika që adresojnë drejtpërdrejt transparencën dhe llogaridhënien në punën e Qeverisë dhe Kuvendit. Nuk identifikohen dispozita që parashohin konsultime publike të detyrueshme, publikim të raporteve institucionale, transparencë buxhetore apo mekanizma të veçantë për monitorimin e procesit të hartimit të politikave publike.

Përkundër faktit se programi adreson fusha të ndryshme të reformës institucionale dhe administrative, transparenca institucionale nuk paraqitet si prioritet i veçantë programor. Për rrjedhojë, programi vlerësohet me 0 pikë.

Indikatori: Depolitizimi i administratës publike

Vlerësimi: 0 pikë nga 5 pikë të mundshme

Programi i Lidhjes Demokratike të Kosovës nuk paraqet politika të qarta që lidhen me depolitizimin e administratës publike. Edhe pse në disa pjesë të programit identifikohen referenca ndaj profesionalizmit dhe procedurave të bazuara në vlerësim profesional, këto masa kufizohen kryesisht në sektorë të veçantë dhe nuk adresojnë administratën publike në tërësi.

Programi nuk trajton rekrutimin meritokratik në shërbimin civil, nuk adreson pozitën e ushtruesve të detyrës dhe nuk paraqet masa për forcimin e rolit të institucioneve të pavarura që mbikëqyrin administratën publike. Po ashtu, mungojnë mekanizmat që do të garantonin mbrojtjen e administratës nga ndikimet politike.

Për rrjedhojë, programi nuk adreson elementet e përcaktuara në metodologjinë e këtij indikatori.

Indikatori: Digjitalizimi dhe qeverisja elektronike

Vlerësimi: 4 pikë nga 5 pikë të mundshme

Programi i LDK-së paraqet qasjen më gjithëpërfshirëse ndaj digjitalizimit dhe qeverisjes elektronike. Programi parasheh investime në infrastrukturën kombëtare digjitale, krijimin e cloud-it qeveritar, zhvillimin e qendrave sovrane të të dhënave dhe integrimin e inteligjencës artificiale në administratën shtetërore dhe sistemin e drejtësisë. Një pjesë e rëndësishme e programit është transformimi i platformës e-Kosova në një pikë të vetme të ofrimit të shërbimeve publike.

Programi adreson drejtpërdrejt ndërveprueshmërinë e sistemeve shtetërore, duke synuar që qytetarët të japin të dhënat vetëm një herë, ndërsa institucionet t'i shkëmbejnë ato automatikisht ndërmjet vete. Po ashtu, programi synon që të gjitha shërbimet publike të ofrohen online gjatë mandatit qeverisës dhe paraqet objektiva konkrete infrastrukturore dhe teknologjike.

Megjithatë, ndonëse programi paraqet një vizion të avancuar për transformimin digjital të shtetit, ai nuk përcakton në mënyrë të detajuar afatet e realizimit dhe mekanizmat e monitorimit për të gjitha iniciativat e propozuara. Për rrjedhojë, programi vlerësohet me 4 pikë.

Indikatori 5: Llogaridhënia institucionale

Vlerësimi: 1 pikë nga 5 pikë të mundshme

Programi i LDK-së përmban disa masa që kontribuojnë në rritjen e transparencës, gjurmueshmërisë dhe luftimit të korrupsionit, veçanërisht përmes digjitalizimit të institucioneve publike, reformave në sistemin e drejtësisë dhe procesit të vetingut në Policinë e Kosovës. Këto masa synojnë të kufizojnë hapësirat për keqpërdorime dhe të rrisin përgjegjësinë institucionale.

Megjithatë, programi nuk adreson në mënyrë të drejtpërdrejtë mekanizmat e llogaridhënies institucionale sipas elementeve të përcaktuara në metodologji. Nuk identifikohen masa konkrete për auditim të pavarur, raportim publik periodik, plane të integritetit institucional apo forcim të sistemeve të kontrollit të brendshëm. Po ashtu, mungojnë objektiva të matshme dhe mekanizma monitorimi që do të mundësonin vlerësimin e progresit institucional.

Për rrjedhojë, programi kontribuon vetëm pjesërisht në adresimin e këtij indikatori dhe vlerësohet me 1 pikë.

Përfundim

Në tërësi, programi i LDK-së paraqet një qasje të orientuar drejt modernizimit teknologjik të shtetit dhe përmirësimit të efikasitetit të administratës publike, me theks të veçantë në digjitalizimin e shërbimeve dhe transformimin e qeverisjes elektronike. Kjo përbën pikën më të fortë të programit në fushën e qeverisjes së mirë. Megjithatë, programi mbetet dukshëm më i kufizuar në trajtimin e transparencës institucionale, depolitizimit të administratës publike, barazisë gjinore dhe mekanizmave të llogaridhënies. Për rrjedhojë, programi ofron një vizion relativisht të zhvilluar për modernizimin administrativ dhe teknologjik të shtetit, por nuk paraqet një qasje të balancuar dhe gjithëpërfshirëse ndaj të gjitha komponentëve kryesorë të qeverisjes së mirë.

II. SUNDIMI I LIGJIT

Hyrje e përgjithshme

Analiza e programeve politike të Lëvizjes Vetëvendosje, Partisë Demokratike të Kosovës, Lidhjes Demokratike të Kosovës dhe Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës tregon se sundimi i ligjit vazhdon të mbetet një nga fushat më të rëndësishme për zhvillimin demokratik të Kosovës dhe një nga kriteret kryesore për forcimin e institucioneve, luftimin e korrupsionit dhe avancimin e procesit të integritetit evropian. Përkundër reformave të ndërmarra në vitet e fundit dhe miratimit të Strategjisë për Sundimin e Ligjit 2021–2026, sektori i drejtësisë vazhdon të përballet me sfida që ndërlidhen me efikasitetin e institucioneve, integritetin institucional, luftimin e korrupsionit dhe garantimin e pavarësisë së institucioneve të drejtësisë dhe mediave.

Analiza tregon se programet politike adresojnë në nivele të ndryshme çështjet që lidhen me reformën në drejtësi, luftimin e korrupsionit, integritetin institucional dhe funksionimin e institucioneve demokratike. Megjithatë, në shumicën e rasteve mungojnë referenca të drejtpërdrejta ndaj dokumenteve strategjike ekzistuese, objektivat e matshme, afatet kohore dhe mekanizmat monitorues që do të mundësonin vlerësimin e progresit në zbatimin e reformave të propozuara.

Në këtë kontekst, programet politike janë vlerësuar në bazë të pesë indikatorëve: (1) reforma ligjore në sistemin e drejtësisë, (2) parandalimi dhe luftimi i korrupsionit, (3) integriteti i prokurimit publik, (4) vetingu në drejtësi dhe (5) pavarësia e mediave, Komisionit të Pavarur të Mediave dhe Radiotelevizionit të Kosovës. Vlerësimi synon të identifikojë shkallën në të cilën partitë politike ofrojnë masa konkrete dhe reforma të realizueshme për forcimin e sundimit të ligjit, rritjen e integritetit institucional dhe garantimin e funksionimit të shtetit të së drejtës në Kosovë.

Renditja	Partia Politike	Reforma ligjore në sistemin e drejtësisë në përputhje me rekomandimet e Komisionit të Venecias	Korniza ligjore dhe institucionale për parandalimin dhe luftimin e korrupsionit	Integriteti i prokurimit publik	Vetingu në drejtësi	Pavarësia e mediave, KPM-së dhe RTK-së nga pushteti politik	Totali
1	LVV	2	1	2	2	0	7
2	LDK	3	2	0	0	0	5
3	AAK	2	1	2	0	0	5
4	PDK	2	1	0	0	0	3

Tabela 2. Vlerësimi i programeve politike në fushën e sundimit të ligjit

Programi politik i LVV-së

Vlerësim i përgjithshëm në fushën e Sundimit të Ligjit

Programi i Lëvizjes Vetëvendosje e trajton sundimin e ligjit si një nga prioritetet kryesore të qeverisjes dhe përmban një numër zotimesh që ndërlidhen me reformën në drejtësi, luftimin e korrupsionit, vetingun, digjitalizimin e sistemit gjyqësor dhe forcimin e mekanizmave institucionalë të llogaridhënies. Programi adreson disa prej reformave të iniciuara gjatë mandatit të kaluar dhe parashih vazhdimin e tyre në një mandat të ri qeverisës. Megjithatë, programi nuk i referohet Strategjisë për Sundimin e Ligjit 2021–2026, nuk trajton në mënyrë

të drejtpërdrejtë rekomandimet e Komisionit të Venecias dhe nuk paraqet një vlerësim të rezultateve apo sfidave të hasura gjatë mandatit të kaluar. Po ashtu, një pjesë e zotimeve mbeten të paelaboruara, nuk shoqërohen me objektiva të matshme dhe nuk qartësojnë raportin e tyre me reformat tashmë të ndërmarra nga vetë qeveria e udhëhequr nga LVV. Për rrjedhojë, programi demonstroi orientim reformues në fushën e sundimit të ligjit, por nuk ofron një plan plotësisht të strukturuar dhe të operacionalizuar për realizimin e të gjitha reformave të propozuara.

Indikatori: Reforma ligjore në sistemin e drejtësisë në përputhje me rekomandimet e Komisionit të Venecias

Vlerësimi: 2 pikë nga 5 pikë të mundshme

Programi përmban disa iniciativa që ndërlidhen me reformimin e sistemit të drejtësisë, përfshirë themelimin e Gjykatës për Çështje Familjare, digjitalizimin e proceseve gjyqësore, krijimin e një prokurorie të specializuar për korrupsionin dhe krimin e organizuar dhe themelimin e Zyrës për Hetime Disiplinore. Megjithatë, programi nuk i referohet rekomandimeve të Komisionit të Venecias, nuk trajton çështjet e ngritura në Deklaratën e Përbashkët të Zotimeve dhe nuk paraqet një proces të qartë për reformimin e sistemit të drejtësisë. Për më tepër, disa prej zotimeve nuk shpjegojnë raportin e tyre me institucionet dhe reformat ekzistuese, duke krijuar paqartësi lidhur me realizimin e tyre. Për rrjedhojë, programi adreson pjesërisht reformën ligjore në drejtësi, por nuk ofron një plan të qartë dhe të matshëm për realizimin e saj.

Indikatori: Korniza ligjore dhe institucionale për parandalimin dhe luftimin e korrupsionit

Vlerësimi: 2 pikë nga 5 pikë të mundshme

Programi parasheh disa masa për luftimin e korrupsionit, përfshirë krijimin e Byrosë për Sekuestrimin dhe Konfiskimin e Pasurisë së Pajustificueshme dhe krijimin e një prokurorie të specializuar për korrupsionin dhe krimin e organizuar. Megjithatë, programi nuk adreson nevojën për Strategjinë Kundër Korrupsionit dhe Planin e Veprimit, nuk trajton rolin dhe kapacitetet e Agjencisë për Parandalimin e Korrupsionit dhe nuk paraqet mekanizma të qartë koordinues ndërinstitucionalë. Po ashtu, nuk sqaron mënyrën se si do të adresohen kufizimet kushtetuese të identifikuara nga Gjykata Kushtetuese lidhur me konfiskimin civil. Për rrjedhojë, trajtimi i këtij indikatori mbetet i pjesshëm.

Indikatori: Integriteti i Prokurimit Publik

Vlerësimi: 2 pikë nga 5 pikë të mundshme

Programi e trajton prokurimin publik kryesisht në kontekst të investimeve kapitale dhe menaxhimit të financave publike. Ai premtori procese më transparente, më konkurruese dhe zhvillimin e mëtejshëm të sistemit të e-prokurimit. Megjithatë, programi nuk adreson çështje kyçe si kufizimi i procedurave njëburimore, raportimi publik për procedurat jokonkurruese, forcimi i mekanizmave mbikëqyrës apo reforma të qarta ligjore në këtë fushë. Për rrjedhojë, trajtimi i integritetit të prokurimit publik mbetet i kufizuar dhe kryesisht deklarativ.

Indikator: Vetingu në drejtësi

Vlerësimi: 1 pikë nga 5 pikë të mundshme

Programi i LVV-së është i vetmi që e trajton drejtpërdrejt vetingun në drejtësi dhe e konsideron atë një proces të rëndësishëm për reformimin e sistemit. Megjithatë, vetingu paraqitet si vazhdim i një zotimi të mëhershëm pa ofruar një qasje të re për realizimin e tij. Programi nuk shpjegon se si do të sigurohet shumica e nevojshme kushtetuese për ndryshimet kushtetuese dhe nuk paraqet strategji për tejkalimin e pengesave që kanë bllokuar procesin gjatë mandatit të kaluar. Për rrjedhojë, ndonëse e trajton temën, programi nuk ofron plan konkret për realizimin e saj.

Indikator: Pavarësia e mediave, KPM-së dhe RTK-së nga pushteti politik

Vlerësimi: 0 pikë nga 5 pikë të mundshme

Programi nuk paraqet masa të veçanta që lidhen me pavarësinë institucionale dhe financiare të RTK-së dhe KPM-së. Nuk trajton modelin e financimit të RTK-së, procedurat e emërimit në organet rregullatore dhe as mekanizmat që do të garantonin mbrojtjen e mediave nga ndikimi politik. Për rrjedhojë, kjo fushë mbetet jashtë fokusit programor të LVV-së.

Përfundim

Në tërësi, programi i Lëvizjes Vetëvendosje adreson disa prej temave kryesore që ndërlidhen me sundimin e ligjit, veçanërisht reformën në drejtësi, luftimin e korrupsionit dhe vetingun. Megjithatë, programi nuk demonstroi lidhje të mjaftueshme me dokumentet strategjike ekzistuese, përfshirë Strategjinë për Sundimin e Ligjit 2021–2026, nuk trajton në mënyrë të drejtpërdrejtë rekomandimet e Komisionit të Venecias dhe nuk paraqet mekanizma të qartë për realizimin e një pjese të konsiderueshme të zotimeve. Për më tepër, si program i një partie që ka udhëhequr qeverinë gjatë mandatit të kaluar, ai nuk ofron reflektim të mjaftueshëm mbi pengesat dhe sfidat që kanë ndikuar në realizimin e reformave të paralajmëruara më herët. Për rrjedhojë, programi demonstroi orientim reformues, por ofron një nivel të kufizuar të operacionalizimit dhe matshmërisë së reformave të propozuara.

Programi politik i PDK-së

Vlerësim i përgjithshëm në fushën e Sundimit të Ligjit

Programi i PDK-së e trajton sundimin e ligjit si një nga shtyllat kryesore të qeverisjes dhe i kushton një kapitull të veçantë reformimit të sistemit të drejtësisë. Programi fokusohet kryesisht në përmirësimin e efikasitetit të institucioneve të drejtësisë përmes digjitalizimit, rritjes së kapaciteteve njerëzore, reduktimit të vonësave procedurale dhe përmirësimit të qasjes së qytetarëve në drejtësi. Megjithatë, trajtimi i sundimit të ligjit mbetet kryesisht në nivel të reformave organizative dhe administrative, ndërsa programi nuk adreson në mënyrë të drejtpërdrejtë proceset kryesore reformuese që kanë dominuar debatin publik dhe institucional në vitet e fundit. Po ashtu, programi nuk i referohet Strategjisë për Sundimin e Ligjit 2021–2026, rekomandimeve të Komisionit të Venecias apo çështjeve të ngritura në Deklaratën e Përbashkët të Zotimeve. Për rrjedhojë, programi demonstroi orientim pozitiv drejt forcimit të

efikasitetit të sistemit të drejtësisë, por ofron një trajtim të kufizuar të reformave sistemore në fushën e sundimit të ligjit.

Indikatori: Reforma ligjore në sistemin e drejtësisë në përputhje me rekomandimet e Komisionit të Venecias

Vlerësimi: 2 pikë nga 5 pikë të mundshme

Programi i PDK-së e trajton drejtësinë si shtyllë të shtetit ligjor dhe identifikon disa probleme që lidhen me efikasitetin e sistemit, vonesat në trajtimin e lëndëve dhe qasjen e qytetarëve në drejtësi. Programi parasheh masa si digjitalizimi i proceseve gjyqësore, rritja e numrit të gjyqtarëve dhe prokurorëve, forcimi i kapaciteteve administrative në gjykata dhe prokurori, themelimi i Gjykatës së Punës dhe fuqizimi i ndihmës juridike falas.

Megjithatë, programi nuk e trajton reformën në drejtësi në kuptimin e reformave ligjore dhe institucionale që janë diskutuar gjatë viteve të fundit. Ai nuk i referohet Strategjisë për Sundimin e Ligjit 2021–2026, rekomandimeve të Komisionit të Venecias dhe as çështjeve të ngritura në Deklaratën e Përbashkët të Zotimeve. Po ashtu, nuk identifikon ligjet konkrete që synon të reformojë dhe nuk paraqet një proces të qartë për realizimin e reformave. Për rrjedhojë, programi adreson disa probleme të sistemit të drejtësisë, por nuk ofron një plan të strukturuar për reformimin e tij.

Indikatori: Korniza ligjore dhe institucionale për parandalimin dhe luftimin e korrupsionit

Vlerësimi: 1 pikë nga 5 pikë të mundshme

Programi përmban referenca të përgjithshme për forcimin e sundimit të ligjit, pavarësinë e institucioneve dhe rritjen e llogaridhënies publike. Megjithatë, ai nuk paraqet një qasje të strukturuar për luftimin e korrupsionit dhe nuk trajton nevojën për hartimin e Strategjisë Kundër Korrupsionit dhe Planit të Veprimit.

Po ashtu, programi nuk adreson rolin e Agjencisë për Parandalimin e Korrupsionit, nuk paraqet masa konkrete për rritjen e kapaciteteve të saj dhe nuk propozon mekanizma të rinj për koordinimin institucional në këtë fushë. Për rrjedhojë, trajtimi i luftimit të korrupsionit mbetet kryesisht deklarativ dhe i paelaboruar.

Indikatori: Integriteti i Prokurimit Publik

Vlerësimi: 0 pikë nga 5 pikë të mundshme

Programi nuk e trajton prokurimin publik si fushë të veçantë reformuese dhe nuk adreson problemet strukturore që lidhen me integritetin e sistemit të prokurimit publik. Nuk paraqiten masa për kufizimin e procedurave njëburimore, forcimin e mekanizmave mbikëqyrës, avancimin e konkurrueshmërisë apo reformimin e kornizës ligjore në këtë fushë.

Megjithëse në disa pjesë të programit përmenden transparenca dhe efikasiteti institucional, këto nuk përkthehen në masa konkrete për reformimin e sistemit të prokurimit publik. Për rrjedhojë, programi nuk adreson këtë indikator.

Indikatori: Vetingu në drejtësi

Vlerësimi: 0 pikë nga 5 pikë të mundshme

Programi nuk përmban asnjë referencë për procesin e vetingut apo për mekanizma të ngjashëm të verifikimit të integritetit në sistemin e drejtësisë. Programi fokusohet në rritjen e efikasitetit të institucioneve të drejtësisë dhe përmirësimin e performancës së tyre, por nuk trajton çështjen e integritetit të gjyqtarëve dhe prokurorëve përmes proceseve të vetingut apo reformave të ngjashme.

Për rrjedhojë, programi nuk adreson këtë indikator.

Indikator: Pavarësia e mediave, KPM-së dhe RTK-së nga pushteti politik

Vlerësimi: 0 pikë nga 5 pikë të mundshme

Programi nuk paraqet masa të veçanta që lidhen me pavarësinë institucionale dhe financiare të RTK-së dhe KPM-së. Nuk trajtohen modeli i financimit të RTK-së, procedurat e emërimit në organet rregullatore dhe as mekanizmat që do të garantonin mbrojtjen e mediave nga ndikimi politik.

Po ashtu, programi nuk adreson sfidat që lidhen me funksionimin e Komisionit të Pavarur për Media dhe nuk paraqet reforma konkrete në këtë fushë. Për rrjedhojë, kjo temë mbetet jashtë fokusit programor.

Përfundim

Në tërësi, programi i PDK-së paraqet një qasje më të strukturuar ndaj funksionimit të sistemit të drejtësisë sesa programet e mëparshme të partisë dhe përmban masa që synojnë rritjen e efikasitetit të institucioneve gjyqësore dhe prokuroriale. Megjithatë, në raport me indikatorët e këtij vlerësimi, programi mbetet i kufizuar në trajtimin e reformave sistemore në fushën e sundimit të ligjit. Mungon një qasje e qartë ndaj luftimit të korrupsionit, integritetit të prokurimit publik, procesit të vetingut dhe pavarësisë së mediave, ndërsa reforma në drejtësi trajtohet kryesisht përmes masave organizative dhe administrative. Për rrjedhojë, programi nuk ofron një plan të plotë dhe të operacionalizuar për adresimin e sfidave kryesore në fushën e sundimit të ligjit.

Programi politik i LDK-së

Vlerësim i përgjithshëm në fushën e Sundimit të Ligjit

Programi i LDK-së e trajton sundimin e ligjit si një nga shtyllat e zhvillimit institucional dhe ekonomik të vendit dhe i kushton një kapitull të veçantë drejtësisë. Programi përmban një numër masash që synojnë rritjen e pavarësisë, profesionalizmit dhe efikasitetit të institucioneve të drejtësisë, përfshirë reformimin e Këshillit Gjyqësor të Kosovës dhe Këshillit Prokurorial të Kosovës, digjitalizimin e proceseve gjyqësore dhe krijimin e mekanizmave të specializuar për trajtimin e korrupsionit dhe krimeve ekonomike. Megjithatë, programi nuk i referohet dokumenteve dhe proceseve kryesore reformuese që kanë orientuar sektorin e sundimit të ligjit në vitet e fundit, përfshirë Strategjinë për Sundimin e Ligjit 2021–2026, Deklaratën e Përbashkët të Zotimeve dhe rekomandimet e Komisionit të Venecias. Po ashtu, sundimi i ligjit nuk paraqitet ndër prioritetet kryesore politike të programuara në zotimet qendrore të partisë.

Për rrjedhojë, programi paraqet një qasje relativisht të strukturuar në fushën e drejtësisë, por jo një vizion të plotë reformues për sektorin e sundimit të ligjit.

Indikator: Reforma ligjore në sistemin e drejtësisë në përputhje me rekomandimet e Komisionit të Venecias

Vlerësimi: 2 pikë nga 5 pikë të mundshme

Programi e trajton drejtësinë si parakusht për zhvillim ekonomik, investime dhe rritje të besimit të qytetarëve në institucione. Në këtë drejtim, ai propozon reforma në Këshillin Gjyqësor të Kosovës dhe Këshillin Prokurorial të Kosovës, digjitalizimin e proceseve gjyqësore dhe funksionalizimin e mekanizmave të specializuar për trajtimin e korrupsionit dhe krimeve ekonomike.

Megjithatë, programi nuk e ndërlidh reformën në drejtësi me proceset reformuese të zhvilluara gjatë viteve të fundit. Nuk i referohet Strategjisë për Sundimin e Ligjit, nuk trajton Deklaratën e Përbashkët të Zotimeve dhe nuk adreson rekomandimet e Komisionit të Venecias. Po ashtu, nuk identifikon ligje konkrete që synon t'i reformojë. Për rrjedhojë, programi e adreson këtë indikator vetëm pjesërisht.

Indikator: Korniza ligjore dhe institucionale për parandalimin dhe luftimin e korrupsionit

Vlerësimi: 2 pikë nga 5 pikë të mundshme

Programi përmban disa masa që ndërlidhen me luftimin e korrupsionit, përfshirë krijimin e gjykatave apo dhomave të specializuara për trajtimin e krimeve ekonomike dhe korrupsionit, si dhe forcimin e mbrojtjes së personave që raportojnë rastet e korrupsionit.

Megjithatë, programi nuk paraqet një qasje gjithëpërfshirëse në këtë fushë. Nuk adreson Strategjinë Kundër Korrupsionit dhe Planin e Veprimit, nuk trajton rolin dhe kapacitetet e Agjencisë për Parandalimin e Korrupsionit dhe nuk paraqet mekanizma të qartë për koordinimin institucional në luftimin e korrupsionit. Për rrjedhojë, trajtimi i këtij indikator mbetet i pjesshëm.

Indikator: Integriteti i Prokurimit Publik

Vlerësimi: 0 pikë nga 5 pikë të mundshme

Programi nuk e trajton integritetin e prokurimit publik si fushë të veçantë reformuese. Nuk adresohen procedurat njëburimore, mekanizmat mbikëqyrës, transparencja në kontratat publike apo reforma konkrete ligjore që do të synonin përmirësimin e integritetit në sistemin e prokurimit publik.

Për rrjedhojë, programi nuk adreson këtë indikator.

Indikator: Vetingu në drejtësi

Vlerësimi: 1 pikë nga 5 pikë të mundshme

Programi nuk trajton vetingun në sistemin gjyqësor dhe prokurorial. Megjithatë, ai propozon proces të vetingut në Policinë e Kosovës me qëllim të rritjes së integritetit dhe profesionalizmit të këtij institucioni.

Ndonëse kjo masë lidhet me integritetin institucional në sektorin e sigurisë, ajo nuk adreson drejtpërdrejt indikatorin që mat vetingun e gjyqtarëve dhe prokurorëve. Për rrjedhojë, programi e adreson këtë indikator vetëm në mënyrë të kufizuar.

Indikator: Pavarësia e mediave, KPM-së dhe RTK-së nga pushteti politik

Vlerësimi: 0 pikë nga 5 pikë të mundshme

Programi nuk paraqet masa të veçanta që lidhen me pavarësinë institucionale dhe financiare të RTK-së dhe KPM-së. Nuk trajtohen modeli i financimit të RTK-së, procedurat e emërimit në organet rregullatore dhe as mekanizmat që do të garantonin mbrojtjen e mediave nga ndikimi politik.

Po ashtu, nuk adresohen sfidat që lidhen me funksionimin e Komisionit të Pavarur për Media. Për rrjedhojë, kjo fushë mbetet jashtë fokusit programor.

Përfundim

Në tërësi, programi i LDK-së paraqet një qasje relativisht të strukturuar në fushën e drejtësisë dhe përmban disa masa konkrete që synojnë rritjen e profesionalizmit, pavarësisë dhe efikasitetit të institucioneve të drejtësisë. Megjithatë, programi nuk i ndërlihd këto reforma me dokumentet strategjike dhe proceset reformuese që kanë dominuar sektorin e sundimit të ligjit në vitet e fundit. Për më tepër, mungon një qasje gjithëpërfshirëse ndaj luftimit të korrupsionit, integritetit të prokurimit publik, vetingut në drejtësi dhe pavarësisë së mediave. Për rrjedhojë, programi paraqet disa reforma konkrete në drejtësi, por nuk ofron një plan të plotë dhe të operacionalizuar për avancimin e sundimit të ligjit në Kosovë.

Programi politik i AAK-së

Vlerësim i përgjithshëm në fushën e Sundimit të Ligjit

Programi i AAK-së e trajton sundimin e ligjit kryesisht në funksion të zhvillimit ekonomik, mbrojtjes së investimeve dhe përmirësimit të klimës së biznesit. Ndryshe nga partitë e tjera politike, programi nuk i kushton një kapitull të veçantë drejtësisë apo sundimit të ligjit, por i adreson këto çështje në kuadër të politikave për zhvillimin ekonomik dhe qeverisjen. Programi përmban disa zotime që lidhen me efikasitetin e institucioneve të drejtësisë, forcimin e institucioneve të pavarura, mbrojtjen e të drejtës së pronës dhe rritjen e transparencës në qeverisje. Megjithatë, ai nuk adreson në mënyrë të drejtpërdrejtë proceset kryesore reformuese në sektorin e sundimit të ligjit dhe nuk i referohet dokumenteve strategjike që kanë orientuar reformat në këtë fushë gjatë viteve të fundit. Për rrjedhojë, programi paraqet një qasje të kufizuar dhe selektive ndaj sundimit të ligjit, me fokus më të madh tek aspektet ekonomike sesa tek reforma e sistemit të drejtësisë.

Indikator: Reforma ligjore në sistemin e drejtësisë në përputhje me rekomandimet e Komisionit të Venecias

Vlerësimi: 2 pikë nga 5 pikë të mundshme

Programi fokusohet kryesisht në përmirësimin e efikasitetit të sistemit të drejtësisë, veçanërisht në fushën e drejtësisë komerciale dhe mbrojtjes së investimeve. Ai propozon shkurtimin e afateve gjyqësore për kontestet ekonomike, forcimin e pavarësisë së institucioneve të drejtësisë, mbrojtjen e të drejtës së pronës dhe fuqizimin e institucioneve të pavarura, përfshirë Auditorin e Përgjithshëm, Avokatin e Popullit dhe Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit.

Megjithatë, programi nuk e trajton reformën në drejtësi në kuptimin e reformave ligjore dhe institucionale të diskutuara gjatë viteve të fundit. Nuk i referohet Strategjisë për Sundimin e Ligjit 2021–2026, Deklaratës së Përbashkët të Zotimeve dhe as rekomandimeve të Komisionit të Venecias. Po ashtu, nuk identifikon ligjet konkrete që synon t'i reformojë. Për rrjedhojë, programi e adreson këtë indikator vetëm pjesërisht.

Indikatori: Korniza ligjore dhe institucionale për parandalimin dhe luftimin e korrupsionit

Vlerësimi: 2 pikë nga 5 pikë të mundshme

Programi përmban disa zotime që lidhen me forcimin e institucioneve të pavarura dhe promovimin e konkurrencës së ndershme në ekonomi. Po ashtu, ai thekson nevojën për luftimin e monopoleve dhe praktikave të padrejta në treg, duke e ndërlidhur këtë me integritetin institucional dhe qeverisjen e mirë.

Megjithatë, programi nuk paraqet një qasje gjithëpërfshirëse për luftimin e korrupsionit. Nuk trajton Strategjinë Kundër Korrupsionit dhe Planin e Veprimit, nuk paraqet masa konkrete për forcimin e kapaciteteve të Agjencisë për Parandalimin e Korrupsionit dhe nuk ofron mekanizma të qartë koordinues ndërinstitutionalë. Për rrjedhojë, trajtimi i këtij indikator mbetet i pjesshëm.

Indikatori: Integriteti i Prokurimit Publik

Vlerësimi: 2 pikë nga 5 pikë të mundshme

Programi e trajton prokurimin publik në kuadër të transparencës dhe luftimit të korrupsionit. Ai thekson rëndësinë e prokurimit transparent, mbikëqyrjes së pavarur dhe kodeve të avancuara të etikës, si dhe propozon krijimin e një Platforme Kombëtare për Transparencë në Qeverisje, e cila do të mundësonte monitorimin në kohë reale të shpenzimeve publike, kontratave të prokurimit dhe projekteve qeveritare.

Megjithatë, programi nuk adreson çështje kyçe që lidhen me integritetin e sistemit të prokurimit publik, përfshirë kufizimin e procedurave njëburimore, forcimin e institucioneve mbikëqyrëse, raportimin e procedurave jokonkurrese dhe reformimin e kornizës ligjore në këtë fushë. Për rrjedhojë, trajtimi i këtij indikator mbetet i pjesshëm.

Indikatori: Vetingu në drejtësi

Vlerësimi: 0 pikë nga 5 pikë të mundshme

Programi nuk përmban asnjë referencë për procesin e vetingut apo për mekanizma të ngjashëm të verifikimit të integritetit në sistemin gjyqësor dhe prokurorial. Programi fokusohet në

pavarësinë dhe efikasitetin e institucioneve të drejtësisë, por nuk trajton çështjen e vlerësimit të integritetit të gjyqtarëve dhe prokurorëve.

Për rrjedhojë, programi nuk adreson këtë indikator.

Indikatori: Pavarësia e mediave, KPM-së dhe RTK-së nga pushteti politik

Vlerësimi: 0 pikë nga 5 pikë të mundshme

Programi nuk paraqet masa të veçanta që lidhen me pavarësinë institucionale dhe financiare të RTK-së dhe KPM-së. Nuk trajtohen modeli i financimit të RTK-së, procedurat e emërimit në organet rregullatore dhe as mekanizmat që do të garantonin mbrojtjen e mediave nga ndikimi politik.

Po ashtu, nuk adresohen sfidat që lidhen me funksionimin e Komisionit të Pavarur për Media. Për rrjedhojë, kjo fushë mbetet jashtë fokusit programor.

Përfundim

Në tërësi, programi i AAK-së paraqet një qasje të kufizuar në fushën e sundimit të ligjit, duke e trajtuar drejtësinë kryesisht në funksion të zhvillimit ekonomik, mbrojtjes së investimeve dhe përmirësimit të klimës së biznesit. Programi përmban disa masa që lidhen me efikasitetin e institucioneve të drejtësisë, forcimin e institucioneve të pavarura dhe rritjen e transparencës në qeverisje, por nuk ofron një vizion të plotë për reformimin e sektorit të sundimit të ligjit. Mungon referimi ndaj dokumenteve kryesore strategjike dhe proceseve reformuese të viteve të fundit, ndërsa tema të rëndësishme si vetingu në drejtësi dhe pavarësia e mediave mbeten të paadresuara. Për rrjedhojë, programi adreson vetëm pjesërisht indikatorët e këtij vlerësimi.

III. INTEGRIMI EVROPIAN

Hyrje e përgjithshme

Analiza e programeve politike të Lëvizjes Vetëvendosje, Partisë Demokratike të Kosovës, Lidhjes Demokratike të Kosovës dhe Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës tregon se integrimi evropian vazhdon të mbetet një nga objektivat strategjike dhe prioritetet kryesore të Republikës së Kosovës. Përveç përmbushjes së kriterëve të parapara me Marrëveshjen e Stabilizim Associmit si dhe rekomandimeve specifike të dala nga Raporti për Vendin i Komisionit Evropian, që nga viti i kaluar procesi i integritetit është ndërlidhur ngushtë edhe me zbatimin e Planit të Rritjes për Kosovën, si instrumente kyçe për avancimin e reformave dhe përfitimin e mbështetjes financiare nga Bashkimi Evropian. Analiza tregon dallime të konsiderueshme në nivelin e elaborimit të politikave dhe masave konkrete për realizimin e këtyre objektivave. Në përgjithësi, programet politike dominohen nga orientime strategjike dhe objektiva të përgjithshme politike, ndërsa në shumicën e rasteve mungojnë objektivat e matshme, afatet kohore, treguesit e performancës dhe mekanizmat e monitorimit që do të mundësonin vlerësimin e progresit në procesin e integritetit evropian.

Në këtë kontekst, programet politike të partive parlamentare janë vlerësuar në bazë të dy indikatorëve: (1) përmbushja e kriterëve për anëtarësim në Bashkimin Evropian, përfshirë

Planin e Rritjes, dhe (2) avancimi i statusit të Kosovës në procesin e integritimit evropian. Vlerësimi synon të identifikojë shkallën në të cilën partitë politike trajtojnë integrimin evropian përmes reformave konkrete, objektive të matshme dhe masave që mund të kontribuojnë në avancimin e Kosovës drejt anëtarësimit në Bashkimin Evropian.

Renditja	Partia Politike	Përbushja e kriterëve për anëtarësim në BE, përfshirë Planin e Rritjes	Transparenca & Llogaridhënia	Totali
1	PDK	3	3.5	6.5
2	LVV	3	3	6
3	LDK	2.5	3	5.5
4	AAK	2.5	2.5	5

Tabela 3. Vlerësimi i programeve politike në fushën e integritimit evropian

Programi politik i PDK-së

Vlerësim i përgjithshëm në fushën e Integritimit Evropian

Programi i PDK-së e trajton integrimin evropian si prioritet strategjik dhe adreson nevojën për vazhdimin e reformave që ndërlidhen me procesin e anëtarësimit në Bashkimin Evropian. Programi fokusohet në përafrimin gradual të institucioneve, politikave dhe legjislacionit të Kosovës me standardet evropiane, si dhe në forcimin e kapaciteteve shtetërore për zbatimin e reformave. Megjithatë një pjesë e reformave të propozuara përkojnë me prioritetet që promovohen nga Bashkimi Evropian, programi nuk trajton në mënyrë të veçantë Planin e Rritjes apo Agjendën e Reformave dhe nuk paraqet mekanizma specifike për zbatimin e tyre.

Indikatori: Avancimi i statusit të Kosovës në procesin e integritimit evropian

Vlerësimi: 3 pikë nga 5 pikë të mundshme

Programi i PDK-së e trajton integrimin evropian si një ndër prioritetet strategjike të qeverisjes dhe e paraqet anëtarësimin në Bashkimin Evropian si objektivi të rëndësishëm të zhvillimit të vendit. Programi përmban zotime që ndërlidhen me avancimin e reformave në fusha të ndryshme të qeverisjes, forcimin e sundimit të ligjit, përmirësimin e klimës ekonomike dhe rritjen e kapaciteteve institucionale, të cilat paraqiten si elemente të rëndësishme për afrimin e Kosovës me standardet evropiane.

Po ashtu, programi e ndërlidh procesin e integritimit evropian me zhvillimin ekonomik, tërheqjen e investimeve dhe modernizimin e institucioneve publike, duke e konsideruar integrimin evropian si instrument për përmirësimin e mirëqenies së qytetarëve dhe forcimin e shtetit.

Megjithatë, programi nuk paraqet masa të detajuara për përbushjen e kriterëve të anëtarësimit në Bashkimin Evropian dhe nuk trajton në mënyrë të drejtpërdrejtë zbatimin e Planit të Rritjes apo Agjendës së Reformave. Gjithashtu, mungojnë objektiva të matshme, rezultate konkrete dhe afate kohore që do të mundësonin vlerësimin e progresit në procesin e integritimit evropian. Për rrjedhojë, programi adreson rëndësinë e reformave që ndërlidhen me integrimin evropian, por nuk ofron një plan të detajuar dhe të matshëm për përbushjen e obligimeve që rrjedhin nga procesi i anëtarësimit në Bashkimin Evropian.

Indikator: Avancimi i statusit të Kosovës në procesin e integrimit evropian

Vlerësimi: 3.5 pikë nga 5 pikë të mundshme

Programi i PDK-së e trajton integrimin evropian si një prioritet strategjik të politikës së jashtme dhe zhvillimit të vendit. Në program, avancimi i Kosovës drejt strukturave evropiane paraqitet si pjesë e vizionit për forcimin e subjektivitetit ndërkombëtar të shtetit, konsolidimin e institucioneve demokratike dhe përshpejtimin e reformave në fushat kyçe të qeverisjes. Programi parasheh forcimin e marrëdhënieve me Bashkimin Evropian dhe shtetet anëtare, si dhe rikthimin e besueshmërisë së Kosovës në raport me partnerët evropianë përmes stabilitetit institucional dhe reformave të qëndrueshme.

Në program përcaktohen edhe objektiva konkrete që lidhen me avancimin e statusit të Kosovës në raport me institucionet evropiane, përfshirë intensifikimin e përpjekjeve për anëtarësim në Këshillin e Evropës dhe fitimin e statusit të vendit kandidat për anëtarësim në Bashkimin Evropian. Këto objektiva tejkalojnë nivelin e deklarimeve të përgjithshme politike dhe paraqesin rezultate të pritshme që lidhen drejtpërdrejt me avancimin e pozitës së Kosovës në procesin integruar.

Po ashtu, programi e ndërlidh procesin e integrimit evropian me forcimin e sundimit të ligjit, funksionalizimin e institucioneve, përmirësimin e qeverisjes dhe zhvillimin ekonomik, duke e trajtuar integrimin si një proces transformues që duhet të prodhojë përfitime konkrete për shtetin dhe qytetarët. Në këtë aspekt, programi e konsideron përparimin në procesin integruar si rezultat të reformave të brendshme dhe jo vetëm të angazhimit diplomatik.

Megjithatë, programi nuk paraqet masa të detajuara për realizimin e këtyre objektivave, nuk specifikon hapat diplomatikë dhe institucionalë që do të ndërmerren për sigurimin e statusit të vendit kandidat, dhe nuk përcakton afate kohore për arritjen e këtyre synimeve. Gjithashtu, mungojnë tregues të matshëm dhe mekanizma monitorimi që do të mundësonin vlerësimin e progresit në raport me objektivat e shpallura. Për rrjedhojë, programi adreson në mënyrë substanciale avancimin e statusit të Kosovës në procesin e integrimit evropian, por nuk ofron një plan plotësisht të operacionalizuar dhe të matshëm për realizimin e këtyre synimeve, çka justifikon vlerësimin me 3.5 pikë nga 5 pikë të mundshme.

Përfundim

Në tërësi, programi i PDK-së paraqet një nga qasjet më të strukturuar në raport me integrimin evropian, duke e trajtuar atë si prioritet strategjik të qeverisjes dhe politikës së jashtme. Programi adreson si dimensionin e reformave të brendshme ashtu edhe atë të avancimit politik dhe diplomatik të Kosovës në raport me Bashkimin Evropian, ndërsa integrimin evropian e ndërlidh me zhvillimin ekonomik, forcimin e sundimit të ligjit, përmirësimin e qeverisjes dhe rritjen e mirëqenies së qytetarëve. Po ashtu, programi përcakton objektiva konkrete si fitimi i statusit të vendit kandidat për anëtarësim në Bashkimin Evropian dhe anëtarësimi në Këshillin e Evropës. Megjithatë, shumica e zotimeve mbeten në nivel të orientimeve strategjike dhe nuk shoqërohen me masa të detajuara, objektiva të matshme, afate kohore apo mekanizma të qartë monitorimi dhe zbatimi. Për rrjedhojë, programi demonstroi një orientim të qartë pro-evropian

dhe një nivel të konsiderueshëm të përputhshmërisë me prioritetet e procesit integruar, por pa ofruar një plan plotësisht të operacionalizuar për realizimin e tyre.

Programi politik i LVV-së

Vlerësimi i përgjithshëm në fushën e Integritimit Evropian

Programi politik i Lëvizjes Vetëvendosje e trajton integrimin evropian si pjesë të procesit të përgjithshëm të reformave dhe paraqet integrimin evropian si pjesë të politikës së jashtme. Programi fokusohet në përmbushjen një numër të konsiderueshëm masash dhe reformash që ndërlidhen me agjendën evropiane, në disa raste me objektiva dhe rezultate të qarta por që nuk janë të shoqëruara me tregues të qartë matës.

Edhe pse programi ka një fokus në vazhdimin e reformave dhe prioritetëve të ndjekura gjatë mandatit të deritanishëm qeverisës, ai nuk ofron një analizë të qartë të pengesave dhe sfidave që kanë ndikuar në ritmin e procesit integruar. Po ashtu, programi nuk paraqet në mënyrë të mjaftueshme se çfarë do të ndryshojë në qasjen institucionale dhe politike në një mandat të ri qeverisës për të përshpejtuar avancimin e Kosovës drejt Bashkimit Evropian.

Indikator: Përmbushja e kriterëve për anëtarësim në Bashkimin Evropian, përfshirë Planin e Rritjes

Vlerësimi: 3 pikë nga 5 pikë të mundshme

Programi i Lëvizjes Vetëvendosje e trajton integrimin evropian si një nga prioritetet strategjike të qeverisjes dhe e paraqet procesin e integritimit si pjesë të transformimit institucional dhe zhvillimit afatgjatë të vendit. Programi adreson në mënyrë të drejtpërdrejtë Agjendën e Reformave dhe Planin e Rritjes për Ballkanin Perëndimor, duke i konsideruar ato si instrumente të rëndësishme për avancimin e reformave dhe afrimin e Kosovës me Bashkimin Evropian.

Programi parasheh një numër reformash në fusha të ndryshme, përfshirë sundimin e ligjit, administratën publike, energjinë, zhvillimin ekonomik dhe digjitalizimin. Megjithatë, në shumicën e rasteve këto reforma paraqiten si prioritete sektoriale të qeverisjes dhe jo si masa që ndërlidhen drejtpërdrejt me kriteret e anëtarësimit në Bashkimin Evropian apo me obligimet që rrjedhin nga procesi i integritimit evropian. Për më tepër, programi nuk ofron qartësi të mjaftueshme lidhur me mënyrën se si procesi i integritimit evropian dhe zbatimi i Agjendës së Reformave do të përkthehen në përfitime konkrete për qytetarët, institucionet dhe zhvillimin ekonomik të vendit.

Po ashtu, programi nuk përcakton objektiva të matshme, rezultate konkrete apo mekanizma monitorimi që do të mundësonin vlerësimin e progresit në përmbushjen e reformave që ndërlidhen me procesin e anëtarësimit. Për rrjedhojë, programi adreson elemente të rëndësishme të këtij indikator dhe trajton në mënyrë më të drejtpërdrejtë Agjendën e Reformave dhe Planin e Rritjes sesa partitë e tjera politike, por nuk ofron një plan plotësisht të operacionalizuar dhe të matshëm për përmbushjen e kriterëve të anëtarësimit në Bashkimin Evropian.

Indikator: Avancimi i statusit të Kosovës në procesin e integritimit evropian

Vlerësimi: 3 pikë nga 5 pikë të mundshme

Programi i LVV-së e trajton integrimin evropian si prioritet strategjik të politikës së jashtme. Programi mbështetet në aplikimin tashmë të dorëzuar për marrjen e statusit të vendit kandidat për anëtarësim në Bashkimin Evropian dhe parashih vazhdimin e reformave në sektorë të tjerë që ndërlidhen me procesin integruar. Po ashtu, programi përcakton objektiva që lidhen me përmbushjen e obligimeve që rrjedhin nga statusi i vendit kandidat dhe avancimin e negociatave me Bashkimin Evropian deri në vitin 2030, duke i konsideruar reformat e brendshme si parakusht për avancimin e mëtejshëm të Kosovës në procesin e integritit evropian.

Megjithatë, programi nuk paraqet një strategji të veçantë për avancimin formal të statusit të Kosovës në procesin e integritit evropian dhe nuk përcakton objektiva konkrete që lidhen me fazat e ardhshme të procesit të anëtarësimit. Ndryshe nga programet që përcaktojnë synime specifike si fitimi i statusit kandidat apo anëtarësimi në organizata evropiane, programi i LVV-së mbështetet kryesisht në supozimin se progresi në reforma do të reflektohet automatikisht në avancimin e procesit integruar.

Po ashtu, programi nuk ofron masa të detajuara diplomatike, afate kohore apo mekanizma monitorimi që do të mundësonin vlerësimin e progresit në raport me avancimin e statusit të Kosovës në Bashkimin Evropian. Për rrjedhojë, programi demonstroi orientim të qartë evropian dhe adreson një numër të konsiderueshëm reformash relevante për procesin integruar, por trajtimi i avancimit të statusit të Kosovës në raport me Bashkimin Evropian mbetet kryesisht indirekt dhe në nivel të përgjithshëm.

Përfundim

Në tërësi, programi i Lëvizjes Vetëvendosje paraqet një qasje relativisht të strukturuar dhe të orientuar drejt integritit evropian. Programi e lidh procesin e integritit me reformat e brendshme dhe me zhvillimin ekonomik të vendit, si dhe adreson zbatimin e Agjendës së Reformave dhe Planit të Rritjes. Megjithatë, si program i një partie që ka udhëhequr qeverinë gjatë mandatit të kaluar, ai nuk ofron një reflektim të mjaftueshëm mbi sfidat, vonesat dhe rezultatet e deritanishme të procesit integruar, si dhe nuk paraqet qartë se çfarë ndryshimesh në qasje do të ndërmerren për të adresuar këto sfida në një mandat të ardhshëm. Për më tepër, një pjesë e konsiderueshme e zotimeve mbeten në nivel strategjik dhe nuk shoqërohen me objektiva të matshme, afate kohore apo mekanizma të qartë të monitorimit dhe vlerësimit të progresit.

Programi politik i LDK-së

Vlerësim i përgjithshëm në fushën e Integritit Evropian

Programi i LDK-së e trajton integrimin evropian si një nga prioritetet strategjike të qeverisjes dhe e paraqet anëtarësimin në Bashkimin Evropian si objektiv qendror të zhvillimit politik dhe institucional të vendit. Programi e ndërlidh procesin integruar me zbatimin e Planit të Rritjes, nevojës për hartimin e një plani kombëtar për zbatimin e tij dhe një qasjeje të përshpejtuar ("fast-track") për integrimin evropian. Megjithatë, shumica e zotimeve mbeten në nivel të orientimeve strategjike dhe objektivave të përgjithshme politike, pa paraqitur masa konkrete, mekanizma institucionalë, objektiva të matshme apo afate kohore për realizimin e tyre. Për më

tepër, programi nuk sqaron në mënyrë të mjaftueshme se si do të zbatohen propozimet e paraqitura dhe si do të monitorohet progresi në përmbushjen e obligimeve që rrjedhin nga procesi i integritimit evropian. Për rrjedhojë, programi demonstroi orientim të qartë evropian dhe adreson disa nga instrumentet kryesore të procesit integruar, por nuk ofron një plan plotësisht të operacionalizuar për realizimin e tyre.

Indikator: Përmbushja e kriterëve për anëtarësim në Bashkimin Evropian, përfshirë Planin e Rritjes

Vlerësimi: 2.5 pikë nga 5 pikë të mundshme

Programi i LDK-së e trajton integritimin evropian si një nga prioritetet strategjike të qeverisjes dhe e konsideron anëtarësimin në Bashkimin Evropian si objektivi afatgjatë të zhvillimit politik dhe institucional. Programi përmban një numër zotimesh që ndërlidhen me forcimin e sundimit të ligjit, modernizimin e administratës publike, zhvillimin ekonomik dhe përmirësimin e kapaciteteve shtetërore, të cilat paraqiten si elemente të rëndësishme për afrimin e Kosovës me standardet evropiane. Megjithatë, shumica e reformave paraqiten si prioritete të përgjithshme të qeverisjes dhe jo si masa të lidhura drejtpërdrejt me përmbushjen e kriterëve të anëtarësimit në Bashkimin Evropian.

Programi i referohet Planit të Rritjes dhe thekson nevojën për hartimin e një plani kombëtar për zbatimin e tij, si dhe propozon përshejtimin e procesit të integritimit evropian përmes një qasjeje “fast-track”, të bazuar në përvojat e shteteve që kanë kaluar me sukses procesin e anëtarësimit në Bashkimin Evropian. Po ashtu, programi nënvizon rëndësinë e bashkëpunimit të ngushtë me institucionet e Bashkimit Evropian dhe shtetet anëtare. Megjithatë, programi nuk paraqet masa konkrete, mekanizma institucionalë apo hapa të qartë që do të mundësonin zbatimin e kësaj qasjeje, realizimin e Planit të Rritjes apo përmbushjen e obligimeve që rrjedhin nga procesi i integritimit evropian.

Po ashtu, programi i mungon objektiva të matshme, tregues të performancës dhe mekanizma monitorimi që do të mundësonin vlerësimin e progresit në përmbushjen e kriterëve për anëtarësim në Bashkimin Evropian. Për rrjedhojë, programi adreson rëndësinë e integritimit evropian, përmend Planin e Rritjes dhe nevojën për përshejtimin e procesit integruar, por nuk ofron një plan të detajuar dhe të operacionalizuar për përmbushjen e kriterëve dhe obligimeve që rrjedhin nga procesi i anëtarësimit në Bashkimin Evropian.

Indikator: Avancimi i statusit të Kosovës në procesin e integritimit evropian

Vlerësimi: 3 pikë nga 5 pikë të mundshme

Programi i LDK-së e trajton integritimin evropian si prioritet strategjik të politikës së jashtme dhe zhvillimit të vendit. Programi synon avancimin e statusit të Kosovës në procesin e integritimit evropian përmes forcimit të partneritetit me Bashkimin Evropian dhe shtetet anëtare, si dhe përmes përshejtitimit të reformave që lidhen me sundimin e ligjit, qeverisjen demokratike dhe zhvillimin ekonomik.

Programi propozon një qasje të përshejtuar (“fast-track”) për integritimin evropian, të mbështetur në përvojat e vendeve që kanë kaluar me sukses procesin e anëtarësimit në

Bashkimin Evropian. Po ashtu, ai thekson nevojën për thellimin e bashkëpunimit me institucionet e Bashkimit Evropian dhe shtetet anëtare, si dhe për forcimin e kapaciteteve shtetërore për menaxhimin e procesit integruar. Këto elemente tregojnë një orientim të qartë pro-evropian dhe identifikojnë disa nga drejtimet kryesore të veprimit për avancimin e statusit të Kosovës në raport me Bashkimin Evropian.

Megjithatë, programi nuk përcakton objektiva konkrete dhe të matshme lidhur me fazat e ardhshme të procesit të integritit evropian dhe nuk paraqet një strategji të detajuar për realizimin e qasjes së propozuar “fast-track”. Gjithashtu, mungojnë afatet kohore, treguesit e performancës dhe mekanizmat monitorues që do të mundësonin vlerësimin e progresit drejt objektivave të shpallura. Për më tepër, programi nuk sqaron se çfarë veprimesh specifike do të ndërmerren për të krijuar kushtet e nevojshme për avancimin formal të statusit të Kosovës në raport me Bashkimin Evropian.

Për rrjedhojë, programi demonstroi një orientim të qartë pro-evropian, përmend objektiva dhe prioritetet që lidhen me avancimin e statusit të Kosovës në procesin integruar dhe parasheh forcimin e bashkëpunimit me Bashkimin Evropian, por nuk ofron një plan të operacionalizuar dhe të matshëm për realizimin e këtyre synimeve.

Përfundim

Në tërësi, programi i LDK-së paraqet një qasje të qartë pro-evropiane dhe e vendos integrimin evropian në prioritetin e 36 të qeverisjes në kuadër kapitullit Kosova-Shtet i Aleancave. Programi adreson nevojën për përmbytjen e reformave, forcimin e bashkëpunimit me Bashkimin Evropian dhe shtetet anëtare, si dhe shfrytëzimin e instrumenteve si Plani i Rritjes për të mbështetur zhvillimin e vendit dhe procesin integruar. Megjithatë, shumica e zotimeve mbeten në nivel strategjik dhe nuk shoqërohen me masa konkrete, objektiva të matshme apo mekanizma të qartë zbatimi dhe monitorimi. Për këtë arsye, programi paraqet një vizion të përgjithshëm për avancimin e Kosovës në procesin e integritit evropian, por ofron më pak qartësi lidhur me mënyrën konkrete se si do të arrihen këto synime.

Programi politik i AAK-së

Vlerësim i përgjithshëm në fushën e Integritit Evropian

Programi i AAK-së e trajton integrimin evropian dhe euro-atlantik si një nga prioritetet kryesore të vendit. Programi e ndërlidh procesin integruar me forcimin e shtetit, sigurinë kombëtare, zhvillimin ekonomik dhe avancimin e subjektivitetit ndërkombëtar të Kosovës. Po ashtu, programi parasheh forcimin e bashkëpunimit me Bashkimin Evropian, shtetet anëtare dhe partnerët strategjikë perëndimorë, si dhe propozon hartimin e një Plani Kombëtar për Anëtarësim në Bashkimin Evropian.

Megjithatë, trajtimi i integritit evropian mbetet kryesisht në nivel të orientimeve strategjike dhe objektivave politike të përgjithshme. Programi nuk adreson në mënyrë të drejtpërdrejtë Planin e Rritjes, nuk paraqet masa konkrete për përmbytjen e obligimeve që rrjedhin nga procesi i anëtarësimit dhe nuk ofron objektiva të matshme, afate kohore apo mekanizma monitorimi për vlerësimin e progresit. Për më tepër, një pjesë e konsiderueshme e programit fokusohet në integrimin euro-atlantik, anëtarësimin në NATO dhe forcimin e pozitës

ndërkombëtare të Kosovës, ndërsa procesi i integrimit në Bashkimin Evropian trajtohet në mënyrë më të përgjithshme dhe më pak të detajuar.

Indikatori: Përmbushja e kriterëve për anëtarësim në Bashkimin Evropian, përfshirë Planin e Rritjes

Në këtë indikator, Vlerësimi: 2.5 pikë nga 5 pikë të mundshme

Vlerësimi: 2.5 pikë nga 5 pikë të mundshme

Programi i AAK-së e trajton integrimin evropian si një nga prioritetet strategjike të zhvillimit të vendit dhe e ndërlidh atë me forcimin e shtetit, sigurinë, zhvillimin ekonomik dhe integrimin euro-atlantik. Programi parasheh hartimin e një Plani Kombëtar për Anëtarësim në Bashkimin Evropian dhe thekson nevojën për përshejtimin e reformave që do ta afronin Kosovën me standardet evropiane.

Po ashtu, programi e ndërlidh procesin integruës me përfitime më të gjera për qytetarët dhe zhvillimin ekonomik të vendit, duke e konsideruar integrimin evropian si instrument për forcimin e institucioneve, rritjen e investimeve dhe përmirësimin e mirëqenies. Megjithatë, shumica e zotimeve mbeten në nivel të objektivave të përgjithshme politike dhe nuk shoqërohen me masa konkrete për përmbushjen e kriterëve të anëtarësimit në Bashkimin Evropian.

Programi nuk adreson në mënyrë të drejtpërdrejtë Planin e Rritjes i cili përbën instrumentin kryesore aktuale të Bashkimit Evropian për avancimin e reformave në vendet e Ballkanit Perëndimor. Po ashtu, mungojnë objektiva të matshme, afate kohore, tregues të performancës dhe mekanizma monitorimi që do të mundësonin vlerësimin e progresit në përmbushjen e obligimeve që rrjedhin nga procesi i integrimit evropian.

Për rrjedhojë, programi demonstroi orientim pro-evropian dhe përcaktoi disa prioritetë që lidhen me avancimin e Kosovës drejt Bashkimit Evropian, por nuk ofron një plan të detajuar dhe të operacionalizuar për përmbushjen e kriterëve të anëtarësimit, zbatimin e instrumenteve aktuale të Bashkimit Evropian apo monitorimin e progresit në këtë proces.

Indikatori: Avancimi i statusit të Kosovës në procesin e integrimit evropian

Vlerësimi: 2.5 pikë nga 5 pikë të mundshme

Programi i AAK-së e trajton integrimin evropian dhe euro-atlantik si një nga prioritetet kryesore të politikës së jashtme dhe zhvillimit të vendit. Programi thekson rëndësinë e forcimit të marrëdhënieve me Bashkimin Evropian, shtetet anëtare dhe partnerët strategjikë perëndimorë, si dhe e ndërlidh avancimin e pozitës ndërkombëtare të Kosovës me procesin e integrimit evropian dhe euro-atlantik.

Programi përcaktoi disa objektiva politike të përgjithshme që lidhen me avancimin e statusit ndërkombëtar të Kosovës, përfshirë përshejtimin e integrimit evropian, fuqizimin e subjektivitetit ndërkombëtar dhe thellimin e bashkëpunimit me partnerët evropianë dhe transatlantikë. Në këtë aspekt, programi demonstroi orientim të qartë pro-evropian dhe e trajtoi integrimin si pjesë të vizionit strategjik për zhvillimin dhe sigurinë e vendit.

Megjithatë, programi nuk paraqet nevojën për avancimin e statusit të Kosovës në procesin e integrimit evropian dhe si rrjedhojë nuk specifikon hapat institucionalë, diplomatikë apo politikë që do të ndërmerren për kalimin në fazat e ardhshme të procesit të anëtarësimit. Po ashtu, mungojnë objektiva të matshme, rezultate të pritshme, afate kohore dhe mekanizma monitorimi që do të mundësonin vlerësimin e progresit në realizimin e synimeve të deklaruara.

Për më tepër, një pjesë e konsiderueshme e programit fokusohet në integrimin euro-atlantik, anëtarësimin në NATO, sigurinë kombëtare dhe forcimin e subjektivitetit ndërkombëtar të Kosovës, ndërsa procesi i integrimit në Bashkimin Evropian trajtohet në mënyrë më të përgjithshme dhe më pak të detajuar. Për rrjedhojë, programi adreson rëndësinë e avancimit të Kosovës në raport me Bashkimin Evropian dhe parasheh forcimin e bashkëpunimit me partnerët evropianë, por nuk ofron një plan të operacionalizuar dhe të matshëm për avancimin formal të statusit të Kosovës në procesin e integrimit evropian.

Përfundim

Në tërësi, programi i AAK-së demonstroi orientim të qartë pro-evropian dhe pro-euro-atlantik dhe e konsideron integrimin ndërkombëtar si një nga prioritetet kryesore të zhvillimit të vendit. Megjithatë, në krahasim me partitë e tjera politike, programi ofron më pak detaje lidhur me procesin teknik të integrimit në Bashkimin Evropian, përmbushjen e kriterëve të anëtarësimit dhe avancimin formal të statusit të Kosovës në raport me Bashkimin Evropian. Për rrjedhojë, programi paraqet një vizion të përgjithshëm politik për integrimin evropian, por nuk ofron një plan të operacionalizuar dhe të matshëm për realizimin e objektivave të shpallura në këtë fushë.

Annex: Indikatorët për vlerësimin e programeve të partive politike

I. QEVERISJA E MIRË

Administrata publike, të drejtat e nëpunësve dhe zbatimi i aktgjyqimeve kushtetuese

1. Titulli i indikatorit - Barazia gjinore dhe të drejtat e grave në programin qeverisës

Përkufizim: Shkalla në të cilën programi trajton të drejtat e grave dhe barazinë gjinore si pjesë qendrore të qeverisjes së mirë – me masa konkrete në punësim, pjesëmarrje në vendimmarrje, buxhetim gjinor dhe luftim të dhunës ndaj grave?

Metodologjia: Matet nëse programi parasheh e një hapur problemin e pabarazisë gjinore në punësim, në vendimmarrje dhe në qasje në drejtësi;

- parasheh masa konkrete për zbatimin e Ligjit për Barazinë Gjinore, përfshirë kuota të qarta dhe mekanizma mbikëqyrës;
- parasheh rritje të pjesëmarrjes së grave në pozita vendimmarrëse në administratë, borde publike dhe ndërmarrje publike;
- parasheh masa konkrete kundër dhunës me bazë gjinore (strehimore, shërbime, koordinim institucional, monitorim zbatimi);
- Adreson nevojën për ndërmarrjen e masave për pavarësi ekonomike të grave
- lidh masat me buxhete të dedikuara dhe afate të qarta;

Pikëzimi (0–5): 0 = Nuk përmendet; 1-2 = Deklaratë e përgjithshme; 3-4 = Përmendet me masa; 5 = Plan i qartë dhe i matshëm.

2. Titulli i indikatorit - Transparenca dhe llogaridhënia në punën e Qeverisë dhe Kuvendit

Përkufizim: Shkalla në të cilën programi paraqet masa apo veprime për qartësinë e procesit të hartimit të politikave në program (publikimi i të dhënave, konsultimet, monitorimi).

Metodologjia: Vlerësohet nëse programi:

- parasheh konsultime publike të detyrueshme,
- parasheh publikimin e të dhënave dhe raporteve,
- parasheh transparencë buxhetore dhe të kontraktimit.

Pikëzimi (0–5): 0 = Nuk përmendet; 1-2 = Deklaratë e përgjithshme; 3-4 = Përmendet me masa; 5 = Plan i qartë dhe i matshëm.

3. Titulli i indikatorit - Depolitizimi i administratës publike

Përkufizim: Masa apo veprime të programit për të kufizuar ndikimin politik në administratë.

Metodologjia: Matet nëse programi:

- parasheh rekrutim meritokratik,
- kufizon pozitat ushtruese,
- rrit rolin e organeve të pavarura (KPMSHC).

Pikëzim (0–5): 0 = Nuk përmendet; 1-2 = Deklaratë e përgjithshme; 3-4 = Përmendet me masa; 5 = Plan i qartë dhe i matshëm.

4. Titulli i indikatorit - Digjitalizimi dhe qeverisja elektronike

Përkufizim: Shkalla në të cilën programi promovon shërbime digjitale, interoperabilitet dhe të dhëna të hapura.

Metodologjia: Matet nëse programi:

- parasheh platforma të integruara,
- përmend ndërveprueshmërinë e sistemeve,
- synon lehtësimin e qasjes së qytetarëve.

5. Pikëzim (0–10): 0 = Nuk përmendet; 1-2 ide të përgjithshme; 3-4 masa konkrete; 5 plan plotë me standarde, afate dhe matje

6. Titulli i indikatorit - Llogaridhënia institucionale

Përkufizim: Sa masa për mbikëqyrje, auditim, raportim vjetor dhe kontroll të brendshëm prezantohen.

Metodologjia: Matet në bazë të:

- mekanizmave të raportimit publik,
- forcimit të auditorëve të pavarur,
- planit të integritetit dhe anti-korrupsion.

Pikëzim (0–5). 0 = Nuk përmendet; 1-2 = Deklaratë e përgjithshme; 3-4 = Përmendet me masa; 5 = Plan i qartë dhe i matshëm.

II. SUNDIMI I RENDIT DHE LIGJIT

1. Titulli i indikatorit - Reforma ligjore në sistemin e drejtësisë në përputhje me rekomandimet e Komisionit të Venecias

Përkufizim: A e trajton programi reformën ligjore në drejtësi si proces të qartë, në përputhje me rekomandimet e Komisionit të Venecias dhe Deklaratën e Përbashkët të Zotimeve?

Metodologjia: Matet në bazë të:

- e njeh problematikën, rekomandimet e Komisionit të Venecias dhe problemet në fushën e reformës në Drejtësi sipas Deklaratës së Përbashkët të Zotimeve;
- liston ligjet kryesore që do të adresohen,
- parashikon proces të qartë procesin
- Parashikon zgjidhje të qarta për çështjet problematike të ngritura
- Premton se nuk do të bëhen “ndryshime selektive dhe jo kushtetuese”
- Premton heqje dorë nga ccdo tendencë e politizimit të sundimit të ligjit

Pikëzim (0–5). 0 = Nuk përmendet; 1-2 = Deklaratë e përgjithshme; 3-4 = Përmendet me masa; 5 = Plan i qartë dhe i matshëm.

2. **Titulli i indikatorit** - Korniza ligjore dhe institucionale për parandalimin dhe luftimin e korrupsionit

Përkufizim: A e trajton programi luftimin e korrupsionit si detyrë konkrete të Qeverisë dhe Kuvendit – në fushën e ligjeve, strategjive, rolit të Agjencisë për Parandalimin e Korrupsionit dhe integritetit institucional?

Metodologjia: e njeh qartë mungesën e kornizës strategjike dhe boshllëqet në zbatimin e ligjeve ekzistuese kundër korrupsionit;

- liston qartë fushat që do të adresohen
- parashikon proces të qartë për:
 - hartimin dhe miratimin e strategjisë dhe planit të veprimit,
 - përfshirjen e institucioneve të pavarura dhe shoqërisë civile,
- parashikon rritje të qartë të kapaciteteve të APK-së (staf, buxhet);
- premtion heqje dorë nga përdorimi selektiv dhe politik i diskursit kundër korrupsionit, duke premtuar mos ndërhyrje në sistemin e drejtësisë, qoftë edhe përmes deklaratave publike

Pikëzimi (0–5). 0 = Nuk përmendet; 1-2 = Deklaratë e përgjithshme; 3-4 = Përmendet me masa; 5 = Plan i qartë dhe i matshëm.

3. **Titulli i indikatorit** - Integriteti i Prokurimit Publik

Përkufizim: A e trajton programi prokurimin publik si fushë të veçantë, me reforma ligjore, kufizim të procedurave një burimore, forcim të institucioneve mbikëqyrëse dhe përdorim të kriterëve adekuate?

Metodologjia: e njeh hapur problemin se korniza ligjore e prokurimit publik është vetëm pjesërisht e harmonizuar me nevojat dhe të drejtat e BE-së dhe se prokurimi publik vazhdon të jetë i ekspozuar ndaj parregullsive, procedurave të planifikuara dobët dhe anashkalimit të procedurave të rregullta, si dhe është përdorur në mënyrë të gjerë procedura një burimore dhe procedurat e mbyllura, me potencial të lartë korruptiv, duke ngritur dyshime serioze për keqpërdorime;

- parashikon masa konkrete për:
 - miratimin brenda afateve të qarta të ligjit të ri për prokurim publik së bashku me aktet nënligjore dhe udhëzimet praktike për zbatim;
 - Përdorimin e procedurave njëburimore vetëm në raste të jashtëzakonshme;
 - Kërkesën që çdo institucion të raportojë publikisht (p.sh. një herë në vit) për numrin, vlerën dhe arsyet e kontratave një burimore dhe procedurave të tjera jo-konkurrese;
 - Forcimin e mekanizmave institucional në fushën e prokurimit publik;
 - Zhvillimin e mëtejshëm të e-prokurimit;
 - Avancimin e konkureshmërisë në procesin e prokurimit publik;
- nuk premtion masa që nënkuptojnë ndërhyrje direkte në procedura dhe hetime të veçanta (p.sh. “do t’i anulojmë të gjitha kontratat e caktuara” pa bazë ligjore), por

fokuset në krijimin e një sistemi të qëndrueshëm, transparent dhe konkurrues të prokurimit publik.

Pikëzim (0–5). 0 = Nuk përmendet; 1-2 = Deklaratë e përgjithshme; 3-4 = Përmendet me masa; 5 = Plan i qartë dhe i matshëm.

4. Titulli i indikatorit - Vetingu në drejtësi

Përkufizim: A e trajton programi çështjen e vetingut në sistemin e drejtësisë?

Metodologjia: A e njeh hapur problemin e mungesës së integritetit dhe besimit në sistemin e drejtësisë dhe paraqet si zgjidhje procesin e vetingut;

- Adreson rekomandimet e Komisionit të Venecias;
- Bazohet në ndryshime kushtetuese dhe ligjore;
- Garanton procese të drejtë
- Qartëson mënyrën e arritjes së shumicës së dyfishtë për ndryshimin e kushtetutës për realizimin e procesit të vetingut

Pikëzim (0–5). 0 = Nuk përmendet; 1-2 = Deklaratë e përgjithshme; 3-4 = Përmendet me masa; 5 = Plan i qartë dhe i matshëm.

5. Titulli i indikatorit - Pavarësia e mediave, KPM-së dhe RTK-së nga pushteti politik

Përkufizim: A e trajton programi lirinë e medias si çështje të pavarësisë së rregullatorit dhe shërbimit publik mediatik, me masa konkrete për financim të qëndrueshëm, emërimet meritorë dhe mbrojtje të gazetarëve nga presioni politik?

Metodologjia: A e njeh hapur problemin e mungesës së pavarësisë së KPM, RTK dhe ndërhyrës në mediat vizive dhe elektronike;

- Programi e njeh hapur problemin e ndërhyrjeve politike në KPM dhe RTK dhe varësisë financiare të RTK-së nga vendime politike;
- Parashikon model të qartë financimi për RTK-në, që siguron stabilitet afatgjatë dhe e mbron nga presioni politik;
- Parashikon procedurën Bazohet në ndryshime kushtetuese dhe ligjore;

Pikëzim (0–5). 0 = Nuk përmendet; 1-2 = Deklaratë e përgjithshme; 3-4 = Përmendet me masa; 5 = Plan i qartë dhe i matshëm.

III. INTEGRIMI EVROPIAN

1. Titulli i indikatorit - Përbushja e kriterëve përfshi planin e rritjes për anëtarësim në Bashkimin Evropian

Përkufizim: Shkalla në të cilën programi politik paraqet objektiva, reforma dhe masa konkrete për avancimin e Kosovës në procesin e integrimit evropian,

përmbushjen e obligimeve që rrjedhin nga procesi i anëtarësimit në Bashkimin Evropian dhe zbatimin e Planit të Rritjes për Kosovën.

Metodologjia: Matet në bazë të:

- trajton integrimin evropian si prioritet strategjik të qeverisjes;
- paraqet masa konkrete për përmbushjen e reformave të nevojshme për anëtarësimin në BE;
- adreson zbatimin e Planit të Rritjes;
- lidh reformat me përfitimet konkrete për qytetarët, institucionet dhe zhvillimin ekonomik të vendit;
- përcakton objektiva, prioritete ose rezultate të pritshme në procesin e integritimit evropian.

Pikëzim (0–5). 0 = Nuk përmendet; 1-2 = Deklaratë e përgjithshme; 3-4 = Përmendet me masa; 5 = Plan i qartë dhe i matshëm.

2. Titulli i indikatorit - Avancimi i statusit të Kosovës në procesin e integritimit evropian

Përkuftizim: Shkalla në të cilën programi politik paraqet objektiva, politika dhe masa konkrete për avancimin e statusit të Kosovës në procesin e integritimit evropian, përfshirë krijimin e kushteve për kalimin në fazat e ardhshme të procesit të anëtarësimit.

Metodologjia: Matet në bazë të:

- trajton integrimin evropian si prioritet strategjik të politikës së jashtme dhe zhvillimit të vendit;
- paraqet masa konkrete për avancimin e statusit të Kosovës në procesin e integritimit evropian;
- parasheh forcimin e bashkëpunimit me institucionet e Bashkimit Evropian dhe shtetet anëtare;
- përcakton objektiva ose rezultate të pritshme lidhur me avancimin e statusit të Kosovës në raport me Bashkimin Evropian.

Pikëzim (0–5). 0 = Nuk përmendet; 1-2 = Deklaratë e përgjithshme; 3-4 = Përmendet me masa; 5 = Plan i qartë dhe i matshëm.

